



**INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETËQEVERISËSE**  
**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**  
**PRIVREMENE SAMOUPRAVNE INSTITUCIJE**  
**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**  
**Ministry of Education, Science & Technology**  
**Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju**

**RAPORT VJETOR I PUNËS ( 2002-2003)**

**Prishtinë,**  
**10 Pril 2003**

## **PËRMBAJTJA**

- I. Hyrje**
- II. Ndërtimi i sistemit të ri të arsimit**
- III. Ndërtimi i MASHT-it**
- IV. Qëllimet e përgjithshme**
- V. Objektivat**
- VI. Strategjia e veprimit**
- VII. Rezultatet e arritura sipas sektoreve (2002/2003)**
- VIII. Pengesat**
- IX. Vazhdimësia**

## **HYRJE**

Qëllimi i këtij raporti është paraqitja e punës njëvjeçare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin vijues MASHT) në një kontekst të caktuar kohor, si vazhdimësi e punës së Departamentit të Arsimit dhe Shkencës (DASH). MASHT - institucion i Qeverisë së Kosovës, përgjegjës për krijimin e politikës drejtuese të sistemit të arsimit në Kosovë, u themelua më 4 mars 2002.

Në kohën e themelimit të MASHT-it, kushtet sociopolitike dhe arsimore në Kosovë ishin të paqëndrueshme. Ishte koha kur, në këtë kontekst, në shoqërinë kosovare ndihej nevoja dhe, njëkohësisht, planifikoheshin ndryshime të mëdha. Institucionet përkatëse të Qeverisë së Kosovës kishin marrë mandatin që këto veprimtari t'i planifikonin mirë, t'i organizonin, t'i drejtonin dhe t'i zbatonin në mënyrë profesionale. Kjo ishte një sfidë e madhe për Qeverinë e Kosovës, por, në veçanti, dhe për MASHT, që drejton fushën më të ndieshme dhe më të rëndësishme, në kohën e ndryshimeve të mëdha në shoqëri – atë të sistemit të arsimit. Marrjen e përgjegjësisë për zhvillimin e sistemit të ri të arsimit, me qëllim që të sigurohet një arsimim më i mirë për të gjithë – një qasje e barabartë për të gjithë pa dallim përkatësie etnike, fetare, politike, sociale, gjinore etj.. Kjo është një sfidë dhe përgjegjësi e madhe për shoqërinë kosovare, por dhe për bashkësinë ndërkombëtare, meqë Kosova, me zhvillimet cilësore në fushën e arsimit, mëton të krijojë një realitet bashkëkohor - një pamje të re, në përputhje me synimet e shoqërisë kosovare për integrim në strukturat dhe mekanizmat ndërkombëtarë.

MASHT mori përgjegjësinë për të udhëhequr sistemin e arsimit, në kohën kur DASH veç kishte hedhur hapin e parë për ndryshime në sistemin e arsimit; në kohën kur një armatë e tërë e punëtorëve arsimorë, e nxënësve dhe e studentëve, ishin dalë shumë të lodhur nga lufta. Punëtorët e arsimorë, të pamotivuar, kishin paga shumë të ulta, infrastruktura e objekteve shkollore ishte në rehabilitim e sipër, por e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat. Mungonin mjetet e mjaftueshme mësimore, infrastruktura ligjore, planprogramet dhe tekstet e reja mësimore. Buxheti i planifikuar nuk ishte i mjaftueshëm. Administrata e MASHT-it ishte e paplotësuar, e paorganizuar dhe e papërvojë që t'u përgjigjej kërkesave të shumta, ndërkohë që ndihma e ndërkombëtarëve ishte e madhe, por me intencën që të zvogëlojë mbështetjen e saj - të tërhiqej gradualisht.

**Tab. 1. Treguesit statistikorë**

<b>Punëtorë të arsimit</b>	<b>29118</b>
<b>Nxënës dhe studentë</b>	<b>450,000</b>
<b>Institucione të arsimit</b>	<b>830</b>
<b>Objekte mësimore</b>	<b>1187</b>
<b>Buxheti</b>	<b>74,563,000</b>

Kjo situatë ishte shumë e pafavorshme për MASHT që të zhvillojë punën normale me qëllimin që të arrijë objektivat e planifikuara. MASHT, duke e ditur përgjegjësinë dhe nevojat e mëdha që shtroheshin, u mobilizua në synimin e saj në objektivat me prioritet për periudhën njëvjeçare dhe atë të zhvillimit afatmesëm të sistemit të arsimit.

E gjithë kjo rezultoi me një zhvillim të shpejtë në të gjitha fushat e sistemit të arsimit (shih nr. II) - realizim të vizionit, të qëllimeve dhe të objektivave kryesore (shih nr. IV dhe V), edhe pse gjatë punës së saj njëvjeçare u ballafaqua me sfida të shumta, pengesa dhe probleme të natyrave të ndryshme.

## **II. NDËRTIMI I SISTEMIT TË ARSIMIT**

E gjithë politika vepruese e MASHT ka qenë dhe është e bazuar dhe e planifikuar në përputhje me strukturën e sistemit të ri të arsimit në Kosovë.

Siç dihet, në Kosovë është vendosur të zbatohet një sistem i ri i arsimit, i cili do të jetë në përputhje me sistemet e arsimit të shumicës së vendeve të rajonit dhe të Evropës, me qëllim që individi dhe shoqëria e re e Kosovës të integrohen në të gjitha zhvillimet dhe mekanizmat rajonalë e evropianë, pra të jetë bashkëpjesëmarrëse e barabartë në të gjitha këto zhvillime.

Ideja kryesore e zbatimit të sistemit të ri të arsimit qëndron në rritjen e shkallës së përgjegjësisë së shtetit dhe të shoqërisë në përgjithësi ndaj arsimit – të zgjerimit të arsimit të obliguar për një vit apo klasë, që do të thotë se shteti, në bazë të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, është i obliguar t'i përballojë të gjitha shpenzimet e shkollimit, nga klasa e parë e arsimit fillor deri në klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët, ndërsa arsimi i mesëm i lartë dhe arsimi i lartë të riprofilizohen dhe të rishkallëzohen në përputhje me nevojat e ekonomisë së vendit.

Tash sistemi i ri i arsimit është i ndërtuar nga:

- Arsimi parashkollor: .....mosha 3 – 6 vjeç
- Arsimi fillor: klasa ..... 1 – 5 (6 – 11 vjeç);
- Arsimi i mesëm i ulët: klasa ..... 6 – 9 (11 – 15 vjeç);
- Arsimi i mesëm i lartë: klasa ..... 10 – 12/13 (15 – 18 vjeç);
- Arsimi i lartë: së paku ..... 3 vjet studime,  
Magjistratura ..... 2 vjet dhe doktratura 3 vjet.

Tërë kjo strukturë i përket arsimit publik – shtetëror, në të cilin shteti, nëpërmjet MASHT, krijon politikën dhe kahet e zhvillimit; organizon, udhëheq dhe financon forma dhe shkallë të ndryshme.

Krahas arsimit publik, tani është krijuar hapësira e zhvillimit edhe për arsimin privat dhe arsimin joformal.

## **III. NDËRTIMI ORGANIZATIV I MASHT**

MASHT, në përputhje me sistemin e ri të arsimit dhe në bazë të funksioneve që burojnë nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 19/20001 mbi Degën e Ekzekutivit të Organeve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, ka planifikuar organizimin e administratës qendrore dhe rajonale.

MASHT është ndërtuar prj dy komponenteve kryesore:

1. Komponenta politike dhe
2. Struktura civile

### **III. 1. Komponenta politike**

Komponenta politike është e përfaqësuar nga Ministri dhe Këshilltarët Politikë të Ministrisë.

#### **III.1.1. Ministri**

Ministri është udhëheqësi më i lartë i MASHT-it, i cili është përgjegjës për:

Krijimin e politikës së veprimit dhe të zbatimit të ligjshmërisë për zhvillimin e arsimit dhe të shkencës në Kosovë; zbatimin e një politike të qartë për zhvillimin e

reformave në sistemin e arsimit, zhvillimin e një sistemi të arsimit të hapur për të gjithë banorët e Kosovës dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së prindërve dhe të komuniteteve në aktivitetet arsimore.

Ministri, për punët dhe aktivitetet zyrtare, e ka vinë e caktuar buxhetore të pavarur nga shërbimi civil në MASHT dhe është në përgjegjësinë e tij të bëjë planifikimin e shpenzimeve për nevojat e ndryshme që ka kabineti i tij.

### **III.1.2. Këshilltarët Politikë të Ministrit**

Kabineti i ministrit është i përbërë prej pesë (5) Këshilltarëve Politikë dhe së paku dy asistente administrative, të cilat janë pjesë e shërbimit civil të MASHT-it.

Këshilltarët politikë e këshillojnë ministrin për të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që ka Ministri në raport me udhëheqjen dhe vendimmarrjen për çështjet që kanë të bëjnë me politikën e MASHT-it në sistemin e arsimit.

Gjithashtu, Këshilltarët kryejnë punë dhe detyra që u cakton Ministri.

### **III.2. Struktura civile**

Shoqëria kosovare është duke i hedhë hapat e parë për krijimin e një shoqërie civile, që do të jetë përgjegjëse për të siguruar një shërbim cilësor demokratik dhe shumë të hapur për të gjithë qytetarët e Kosovës, për këtë qëllim është nxjerrë Rregullorja Nr. 36/2001 mbi Shërbimin Civil të Kosovës. Struktura civile do të përgjigjet për të gjitha shërbimet civile në MASHT dhe në Sistemin e Arsimit në Kosovë.

Shërbimi civil i MASHT-it është i ndërtuar nga Administrata qendrore e MASHT-it dhe nga Administrata lokale.

#### **III.2.1. Administrata qendrore**

Administrata qendrore është strukturë organizative e MASHT-it e përbërë prej të punësuarve sipas procedurës së Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Administrata qendrore është e ndërtuar në mënyrë hierarkike, sipas një organizimi vertikal dhe horizontal. Administrata qendrore është e ndërtuar nga:

- 1. Zyra e Sekretarit të Përhershëm**
- 2. Departamente ( 3 )**
- 3. Sektore ( 12 ) dhe**
- 4. Njësi apo shërbime punuese ( 30 )**

##### **III.2.1.1. Zyra e Sekretarit të Përhershëm**

Zyra e Sekretarit të Përhershëm planifikon, organizon, koordinon, drejton, zbaton dhe mbikëqyrë zhvillimin e të gjitha aktivitetëve në MASHT në përputhje me planin dhe programin e Qeverisë së Kosovës dhe të MASHT-it, si dhe në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi. Ndihehet nga Zyra Ligjore, Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm, Zyra e Revizionit të Brendshëm, Zyra për Planifikim dhe Analizë dhe Zyra për Koordinim Ndërkombëtar.

##### **III.2.1.2. Departamenti**

Struktura e dytë hierarkike e strukturës civile në administratën qendrore është departamenti. Në bazë të natyrës së punëve dhe të prioritetëve që aktualisht janë duke u zhvilluar, MASHT përbëhet nga 3 departamente:

1. Departamenti i Administratës dhe Financave
2. Departamenti i Arsimit dhe
3. Departamenti i Shërbimeve Teknike

#### **2.1.2.1. Departamenti i Administratës dhe Financave**

Është përgjegjës për pranim, organizim dhe aftësim të punëtorëve të MASHT-it, për planifikim dhe organizim të administratës, për krijim, ruajtje dhe mirëmbajtje të dokumentacionit, për planifikim të buxhetit, për prokurim dhe financim të gjithë veprimtarisë në MASHT dhe për informim dhe komunikim me publikun.

Departamenti i Administratës dhe Financave përbëhet nga:

- Sektori i Buxhetit dhe Financave
- Sektori i Prokurimit
- Sektori i Administratës
- Sektori për Informim dhe Komunikim me Publikun

#### **2.1.2.2. Departamenti i Arsimit**

Departamenti i Arsimit është struktura qendrore profesionale apo pjesa programore (softverike) e MASHT-it; është bartësi kryesor i punëve - linjë kryesore vepruese profesionale e MASHT-it; është përgjegjës për planifikim, organizim, koordinim, mbikëqyrjeje të punëve dhe të aktiviteteve në Departament. Njëkohësisht, këshillon Sekretarin e Përhershëm për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punën e Departamentit të Arsimit.

Departamenti i Arsimit përbëhet nga 6 sektore:

- Sektori i Planeve dhe Programeve
- Sektori i Arsimit të Përgjithshëm
- Sektori i Arsimit Profesional
- Sektori i Arsimit të Lartë
- Sektori i Arsimit për Gjini dhe Komunitete
- Sektori i Koordinimit me Komuna

#### **2.1.2.3. Departamenti i Shërbimeve Teknike**

Planifikon, koordinon dhe udhëheq të gjitha projektet që kanë të bëjnë me ndërtimin, zgjerimin, meremetimin dhe infrastrukturën e objekteve shkollore; udhëheq procedurat e nevojshme për sigurimin e pronës së MASHT-it, furnizimin dhe mbështetjen teknike të MASHT, si dhe këshillon Sekretarin e Përhershëm dhe, sipas nevojës, edhe Ministrin, për çështjet që kanë të bëjnë me Departamentin e Shërbimeve Teknike.

Departamenti i Shërbimeve Teknike përbëhet nga 2 sektore:

- Sektori i Infrastrukturës
- Sektori i Mbështetjes Teknike

### **III. 2.2. Administrata rajonale**

MASHT, në përputhje me politikën e gjithmbarshme të decentralizimit, është në proces të ndërtimit dhe të bartjes së disa kompetencave të fushës profesionale në Zyrat Rajonale të arsimit. Janë përcaktuar shtatë rajone:

1. Rajoni i Prishtinës
2. Rajoni i Mitrovicës
3. Rajoni i Pejës
4. Rajoni i Gjakovës
5. Rajoni i Ferizajit
6. Rajoni i Gjilanit
7. Rajoni i Prizrenit

Nëpërmjet të këtyre zyrave, MASHT synon që të jetë më pranë nxënësit dhe arsimtarit dhe t'i mbështesë ata në fusha të ndryshme të nevojave profesionale dhe administrative.

#### **IV. QËLLIMET E PËRGJITHSHME**

Vizioni i MASHT-it për zhvillimin e sistemit të arsimit është: *“Promovimi dhe zbatimi i idesë për arsimim më të mirë për të gjithë, i bazuar në nevojat individuale dhe të shoqërisë kosovare”*. Realizimi i këtij vizioni synohet të arrihet duke i përcaktuar qartë qëllimet e zhvillimit aftgjatë të sistemit të arsimit në Kosovë, si:

- **Unifikimi i sistemit të arsimit;**
- **Sigurimi i hapësirës së nevojshme shkollore për të gjitha nivelet;**
- **Sigurimi i arsimimit për të gjithë;**
- **Arritja e rezultateve të pranueshme të të nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit në përputhje me standardet ndërkombëtare;**
- **Inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë, në përgjithësi, në mbështetje të arsimit;**
- **Informimi publik për rezultatet dhe vështirësitë në sistemin e arsimit-**

Mbi bazën e këtyre qëllimeve, MASHT ka vendosur objektivat e saj prioritare të zhvillimit njëvjeçar.

#### **V. OBJEKTIVAT**

MASHT, që nga fillimi, veprimtarinë e ka bazuar në një udhëheqje profesionale të sistemit të arsimit, duke sajuar një plan të veprimit - i përqendruar saktësisht se çfarë rezultatesh dëshiron të arrijë në këtë fazë të zhvillimit, me qëllim të përmbushjes së nevojave për ndryshime, duke iu shmangur udhëheqjes situacionale - sipas rastit. Kështu, për vitin e parë të veprimit. MASHT planifikon t'i arrijë këto objektiva, apo rezultate:

- Kompletimi i nfrastukturës bazë të rregullativës ligjore;
- Ndërtimi, zgjerimi dhe renovimi i objekteve shkollore në të gjitha nivelet e shkollimit;
- Zbatimi i sistemit të ri të arsimit;
- Zhvillimi i planprogrameve të reja mbi bazën e standardeve ndërkombëtare në të gjitha nivelet e shkollimit;
- Hartimi dhe botimi i teksteve mësimore;
- Aftësimi i mësimitdhënësve për zbatimin e metodologjive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe të mësimitnxënies në të gjitha nivelet;
- Vendosja e standardeve dhe vlerësimi kombëtar;
- Pajisja e shkollave me mjete të nevojshme mësimore;
- Ngritja e qendrave për udhëheqjen e sistemit të informimit në arsim;
- Përmirësimi i kushteve për rritjen e vijueshmërisë së nxënësve në shkollë;
- Përmirësimi i bazës materiale dhe i kushteve të punës për të gjithë punëtorët e arsimit, nxënësit dhe studentët;
- Vazhdimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në të gjitha fushat e arsimit;
- Zhvillimi i projekteve të ndryshme për zhvillimin e arsimit dhe prezentimi para donatorëve ndërkombëtarë;
- Riorganizimi i administratës në institucionet e arsimit në pajtim me rregullativën ligjore.

Për arritjen e këtyre objektivave, u zbatuan mënyrat më të përshtatshme të veprimit.

## **VI. STRATEGJIA E VEPRIMIT**

MASHT zhvilloi një strategji të tillë të veprimit që ishte më e zbatueshme, më e sigurt dhe më pak e kushtueshme. Duke pasë për bazë rrethanat në të cilat MASHT mori përgjegjësinë e udhëheqjes së sistemit të arsimit, zbatoi forma dhe metoda realiste të veprimit, si:

- Aktivizimi dhe mobilizimi i potencialit intelektual ekzistues vendor - pa dallime etnike, politike, gjinore, sociale etj., duke shmangur pritjen e ndihmës vetëm nga jashtë;
- Vazhdimi i bashkëpunimit dhe shfrytëzimi i përvojës ndërkombëtare në fushën e arsimit;
- Aftësimi i punëtorëve arsimor nëpërmjet kurseve, seminareve, punëtorive, ligjëratave dhe prezantimeve të ndryshme në vend dhe jashtë vendit;
- Marrja e përgjegjësive për t'i udhëhequr të gjitha aktivitetet në sistemin e arsimit nga ana e kosovarëve dhe duke vazhduar me bashkëpunimin dhe ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë;
- Sigurimi i të tilla rezultateve që do të jenë të pranueshme për realitetin kosovar e, gjithashtu, edhe për atë ndërkombëtar.

## **VII. REZULTATET E ARRITURA SIPAS SEKTOREVE ( MARS 2002/2003)**

Institucioni i MASHT-it udhëhiqet në bazë të *Planit strategjik afatmesëm (2002-2007)* dhe sipas rezultateve të arritura, të cilat paraprakisht përcaktohen nëpërmjet objektivave të arritshme. Qëllimet dhe objektivat e MASHT-it realizohen nëpërmjet strukturave përkatëse të MASHT-it (shih VI), që secili sektorë, në bazë të funksioneve që ka, punon në arritjen e rezultateve specifike që janë në funksion të arritjes së objektivave dhe të qëllimeve të përgjithshme të MASHT-it.

### **VII. 1. Zyra Ligjore**

Kjo zyrë është shumë e rëndësishme në planifikimin dhe organizimin e prodhimit të infrastrukturës së nevojshme ligjore për MASHT - në veçanti është përgjegjëse për përpilimin e projektligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative, propozimeve dhe rekomandimeve lidhur me rregullimin e funksionimit të gjithmbarshëm të sistemit të arsimit, si dhe lidhur me kontratat dhe memorandumet e mirëkuptimit ndërmjet institucioneve të ndryshme.

Në përputhje me këtë, Zyra Ligjore gjatë vitit 2002/2003 përgatiti aspektin formal të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, i cili ligj u miratua nga Parlamenti i Kosovës më 27 korrik 2002 dhe i shpallur nga PSSP i KB-së më 25 nëntor 2002, si dhe Ligjin për arsimin e lartë, i cili u miratua në Parlamentin e Kosovës më 26 shtator 2002, por që ende nuk është shpallur nga PSSP i KB-së.

Nxjerrjen e udhëzimeve të ndryshme administrative për rregullimin e fushave të caktuara në arsim, si:

- |   |                  |
|---|------------------|
| 1. Data e fillimit të semestrit të dytë             | Nr. DASH 1/2002  |
| 2. Shkollat eksperimentale                          | Nr. DASH 2/2002  |
| 3. Bursat për studentët e komunitetit boshnjak      | Nr. DASH 3/2002  |
| 4. Kontratat e punësimit për Zyrtarët e Arsimit     | Nr. DASH 4/2002  |
| 5. Pagesa shtesë për personelin e shkollave         | Nr. MASHT 5/2002 |
| 6. Vizitat dhe ekskursionet shkollore               | Nr. MASHT 6/2002 |
| 7. Prokurimi i mallrave dhe i shërbimeve            | Nr. MASHT 7/2002 |
| 8. Planprogrami për klasën e nëntë                  | Nr. MASHT 8/2002 |
| 9. Lejimi dhe regjistrimi i institucioneve arsimore | Nr. MASHT 9/2002 |

10. Fillimi i vitit shkollor 2002/2003	Nr. MASHT 10/2002
11. Kalendar i shkollor për vitin shkollor 2002/2003	Nr. MASHT 11/2002
12. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës	Nr. MASHT 12/2002
13. Pagat e mësimdhënësve	Nr. MASHT 13/2002
14. Aktivitetet politike nëpër shkolla	Nr. MASHT 14/2002
15. Aktivitete politike nëpër shkolla	Nr. MASHT 15/2002
16. Përcaktimi i raportit mësues – nxënës	Nr. MASHT 16/2002
17. Vazhdimi i kontratave të të punësuarve	Nr. MASHT 17/2002
18. Kompensimi i orëve të pambajtura	Nr. MASHT 18/2002
19. Procedurat e zgjedhjes së drejtorit të shkollës	Nr. MASHT 19/2002
20. Aplikimi i pagesave të studentëve në U. e Prishtinës	Nr. MASHT 20/2002
21. Kontrata me orar jo të plotë	Nr. MASHT 21/2002
22. Kategoritë e studentëve për asistencë	Nr. MASHT 22/2002
23. Provimet me korrespondencë	Nr. MASHT 1/2003
24. Kontrata me orar jo të plotë	Nr. MASHT 2/2003
25. Licencimi dhe regjistrimi i institucioneve	Nr. MASHT 3/2003
26. Organet qeverisëse, profesionale dhe personeli	Nr. MASHT 4/2003
27. Zyra Rajonale e Arsimit	Nr. MASHT 5/2003

Zyra Ligjore, po ashtu, ka punuar edhe në çështje të tjera me rëndësi juridike për MASHT: ka shqyrtuar ankesa dhe parashtrës me kualifikime të ndryshme juridike; përfaqësim të MASHT-it në gjykata të niveleve të ndryshme, shërbim të ndihmës juridike palëve dhe institucioneve arsimore të Kosovës nga fushëveprimtaria ligjore lidhur me arsimin, si dhe vendosjen e rregullit të brendshëm lidhur me arkivimin e akteve juridike dhe lëndëve të tjera.

Në proces janë nxjerrja e shumë akteve të tjera nënligjore dhe po punohet në mënyrën e përshpejtimit të procedurave për *shpalljen e Ligjit për Arsimin e Lartë (pas dy miratimeve nga Kuvendi i Kosovës) edhe prej PSSP.*

## **VII. 2. Sektori i Buxhetit dhe Financave**

Është përgjegjës për planifikimin e buxhetit dhe të financave. Në vitin buxhetor 2002 MASHT kishte miratuar një buxhet për të gjitha nivelet e shkollimit në vlerë 74.563.000 Euro. Në bazë të raportit të Bankës Botërore, shpenzimet publike për arsimin ishin 3,4% të PBK-ës, që është shumë e ulët në krahasim me vendet e tjera, kur është e ditur ç'strukturë të re të popullsisë ka Kosova.

Mjetet buxhetore në vitin 2002 ishin të dedikuara për:

1. paga	50.695.802 €
2. shërbime dhe mallra	14.966.868 €
3. shpenzime kapitale	3.171.282 €
4. fond rezervë	5.729.050 €

Më 1 janar 2002 MASHT-i ka filluar me decentralizimin e mjeteve në komuna, të dedikuara për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar më 24 tetor 2002 nga MASHT, MFE (AQF) dhe Departamenti i Administratës Lokale.

Decentralizimi i mjeteve për kategoritë e lartëpërmendura do të kryhej si në vijim:

1. 90 % e mjeteve për mallra dhe shërbime të buxhetit do t'u dërgohen drejtpërdrejt komunave nga MFE (AQF);
2. 25 % e mjeteve për shpenzime kapitale gjithashtu do t'u dërgohen komunave drejtpërdrejt nga MFE;

3. Pagat për personelin ndihmës do të decentralizohen dhe drejtpërdrejt do t'u dërgohen komunave nga MFE (AQF);
4. Gjatë 6-mujorit të parë, MASHT do të bëjë shpërndarjen pagave të personelit arsimor;
5. Në 6-mujorin pasues (qershor – shtator), mjetet për paga të personelit arsimor do t'u dërgohen komunave drejtpërdrejt nga MFE.

Gjatë vitit 2002, MASHT ka arritur të realizojë edhe afro 7 mil. Euro për pagesat shtesë të mësimdhënësve dhe për funksionim të klasës së nëntë.

Ky sektor, në përputhje me rekomandimet e MFE-it, ka bërë planifikimin e buxhetit të MASHT-it për vitin 2003. Këtë vit në planifikimin e buxhetit të MASHT-it nuk përfshihet buxheti për arsimin parashkollor, arsimin fillor dhe të mesëm, prandaj vlera e buxhetit për vitin 2003 është 16,671,000 Euro

Kjo vlerë buxhetore është planifikuar për këto kategori të shpenzimeve:

- a. paga 6.907.567 €
- b. mallra dhe shërbime 7.021.000 €
- c. shpenzime kapitale 2.425.000 €

#### **Pagat sipas vijave buxhetore**

1. Shkollat Speciale	473.531 €
2. Universiteti	5.070.272 €
3. Biblioteka	211.564 €
4. Admin. Arsimore	609.976 €
5. Qendra e Studentëve	300.407 €
6. Institutet	241.817 €
<b>Totali</b>	<b>6.907.567 €</b>

#### **Mallrat dhe Shërbimet**

1. Universiteti	4.198.000 €
2. Qendra e studentëve	445.000 €
3. Institutet	415.200 €
4. Shkollat speciale	260.000 €
5. Biblioteka	103.000 €
6. Admin. arsimore	1.169.000 €
7. Trajnim i arsimtarëve	230.000 €
8. Planprograme	200.000 €
<b>Totali</b>	<b>7.020.200 €</b>

#### **Shpenzimet Kapitale**

1. Universiteti	920.000 €
2. Qendra e studentëve	0
3. Institutet	0
4. Shkollat speciale	222.000 €
5. Biblioteka	810.000 €
6. Admin. arsimore	472.000 €
<b>Totali</b>	<b>2.424.000 €</b>

Sektori i buxhetit është duke bashkëpunuar me Bankën Botërore për rishikimin e buxhetit për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në nivelin komunal për vitin 2003. Në bazë të analizave, janë konstatuar gabime të theksuara në planifikim dhe

tani sektori është dalë me një propozim konkret për shmangien e komplikimeve të mundshme buxhetore gjatë vitit 2003 për nivel komunal.

### **VII. 3. Sektori i Prokurimit**

Është përgjegjës për prokurim të shërbimeve dhe të mallrave sipas Udhëzimit Administrativ nr.19/2002. Gjatë vitit 2002/2003 ky sektor ka marrë pjesë në të gjitha procedurat e prokurimit në MASHT dhe në Komuna të ndryshme të Kosovës për hapjen dhe vlerësimin e tendereve për ndërtim dhe renovim të objekteve shkollore.

### **VII. 4. Sektori i Administratës**

Është përgjegjës për planifikim dhe udhëheqje të procedurave të pranimit të personelit të MASHT-it, sigurimin e mbështetjes administrative për funksionet e MASHT-it. Administrata e MASHT-it ka 128 punëtorë prje tyre 36 femra dhe 92 meshkuj, kurse struktura etnike: shqiptarë - 115, serbë - 3, turq - 3, boshnjakë - 3, romë - 2, të tjerë - 2.

Gjatë vitit 2002, sektori:

- Ka shpallur konkurse për pranimin e personelit;
- Ka përgatitur tërë dokumentacionin e nevojshëm për organizimin e intervistave për pranim të personelit në përputhje me Rregulloren e Shërbimit Civil 36/2001;
- Ka udhëhequr procedurën e pranimit të 108 punëtorëve;
- Ka mbajtur procesverbalet, minutazhet dhe lëshimin e kontratave punëtorëve të MASHT-it;
- Ka organizuar së bashku me Ministrinë e Shërbimeve Publike udhëtime jashtë vendit për aftësimin e personelit - gjithsej 24 punëtorë;
- Ka përgatitur format e arkivimit të dokumentacionit të MASHT-it;
- Ka siguruar së bashku me personelin e UNMIK-ut përkthime të shumta për nevoja të MASHT-it.

### **VII. 5. Sektori i Informimit dhe Komunikimit me Publikun**

Është përgjegjës për informim dhe komunikim me publikun, komunikim të brendshëm dhe ndërinstytucional.

Synimi kryesor i këtij Sektori ishte informimi i opinionit kosovar dhe veçanërisht informimi i subjekteve arsimore me punën dhe orientimet politike e programore të MASHT-it për zhvillimin e arsimit në Kosovë dhe për krijimin e raporteve njerëzore në arsimin tonë, me theksim të veçantë për krijimin e barazisë për shkollim për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Zyra e Informimit ka bërë:

- Monitorimin e mediave dhe ka krijuar dokumentacionin informues, ka përcjellë të gjitha aktivitetet e Ministrisë dhe të zyrtarëve të MASHT;
- Ka raportuar për media nga këto aktivitete dhe ka krijuar dokumentacionin përkatës;
- Ka bërë informimin e brendshëm dhe ndërlidhjen informuese me Qeverinë e Kosovës;
- Ka hartuar planet tremujore dhe gjashtëmujore të punës së MASHT-it;
- Ka organizuar konferenca për shtyp të Ministrisë dhe të zyrtarëve të tjerë;
- Ka njoftuar opinionin përmes kumtesave, njoftimeve, informatave dhe raporteve për punën e Ministrisë.

- Ka bërë përgatitjen dhe redaktimin e katër faqeve të kontraktuara në revistën arsimore “Shkëndija”.
- Përmes kësaj zyreje është informuar opinioni për punën arsimore në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. Kjo ka pasur një veprim pozitiv në eliminimin e disa hutive nga dezinformatat në opinion, por edhe për krijimin e një opinioni pozitiv për punën e zhvilluar në të gjitha segmentet e arsimit në Kosovë. Vlen të përmendet njoftimi i opinionit për reformat arsimore në Kosovë, fillimi i punës së klasës së nëntë dhe hapja e Fakultetit të Edukimit, pastaj rastet si greva e arsimtarëve;
- Puna e Qendrës së Studentëve, Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare; për participimin e studentëve për studimet e tyre;
- Krijimi i një atmosfere pozitive për arsimimin e pjesëtarëve të minoriteteve që jetojnë në Kosovë etj.
- Instalimi i programit INFOGADHER 2.0 në 673 shkolla, 609 në gjuhën shqipe dhe në 64 shkolla serbe.
- Për mbledhjen, përpunimin, analizën dhe publikimin e të dhënave për institucionet arsimore, si: nr. e shkollave, të punëtorëve arsimorë, të nxënësve, të studentëve etj.
- Bashkëpunimi me Entin e Statistikave të Kosovës për shkëmbimin e statistikave dhe për mënyrën e publikimit të tyre.

Pengesa kryesore në procesin e punës ishte çështja e padefinuar në nivel të qeverisë e Zyrës së Informimit dhe rolit të saj dhe e zëdhënësit, që është çështje e padefinuar edhe tash; problemet teknike dhe ekipi i pakompletuar i Zyrës së Informimit.

## **VII. 6. Sektori i Planprogrameve**

Përfaqëson linjën kryesore vepruese profesionale në Departamentin e Arsimit dhe në MASHT. Funkzioni kryesor i tij është zhvillimi, zbatimimi dhe vlerësimi i planeve dhe programeve mësimore si dhe rishikimi periodik i tyre me qëllim të avansimit apo të eliminimit të anëve të dobëta të tyre. Vendosija e standardeve dhe vlerësimi i shkallës së arritshmërisë së nxënësve, zhvillimi i strategjive për aftësimin profesional të kuadrit mësimor për zbatimin e planeve dhe programeve të reja mësimore, zhvillimin e teknologjisë për nxënie nga distanca, si dhe sigurimi i kushteve për mësimnxënie tërëjetësore.

### **6.1. Njësia e Planprogrameve**

Në kuadër të Njesisë për zhvillimin e planprogramit punojnë 9 specialistë të fushave të ndryshme lëndore. Puna e tyre është kryesisht për zhvillimin e planprogrameve, udhëheqjen e grupeve të ekspertëve dhe për menaxhimin e procesit të zhvillimit të planprogrameve.

Gjatë kësaj kohe grupi ka punuar intensivisht në:

- Finalizimin e Projektit të Kornizës së Planit dhe Programit të Ri të Kosovës
- Në mars 2002 ka përfunduar diskutimi publik për Kornizën e Planit dhe të Programit të Ri të Kosovës;
- Janë marrë informata kthyesë nga punëtoritë e zhvilluara me ekspertë profesionalë të planprogramit, zyrtarë të arsimit, mësimdhënës, profesorë universiteti, prindër, nxënës e të tjerë të interesur. Informata kthyesë janë marrë edhe nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si dhe nga institucionet e tjera dhe nga mjetet e informimit publik;
- Gjatë muajit mars dhe prill 2002 është bërë sistematizimi dhe përpunimi

informatave kthyses, të cilat janë përpunuar nga Grupi bërthamë i planprogramit dhe specialistë të tjerë.

- Është bërë prezantimi i Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës nga specialistët e Grupit bërthamë i planprogramit në disa punëtori me arsimtarë në tërë Kosovën, të organizuara nga KEDP, agjenci dhe OJQ të tjera. Kjo është bërë edhe për organizim të seminareve me temën: “Nxënësi në qendër” në tetë qendra rajonale.
- Janë organizuar në shtatë qendra të trajnimit në Kosovë, gjatë muajve korrik-gusht 2002, seminare me temën “Planet gjenerative dhe udhëzime të tjera”.
- Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, nga Sektori për zhvillimin e kurrikulit, një numër i specialistëve kanë marrë pjesë në seminare dhe në konferenca ndërkombëtare, si p.sh.: në Bohinj, Lublanë, Paris, Sofje, Tiranë etj.
- Shumica prej këtyre specialistëve morën pjesë edhe në seminare dhe shumë projekte me tema nga arsimi, ambienti, psiko-social, zhvillimin e shkathësive jetësore etj.
- Specialistët e Sektorit të planprogrameve hartuan ose ishin pjesëmarrës në hartimin e disa dokumentave të tjera në frymën e reformave të reja në arsimin parashkollor, arsimin e të rriturve, arsimimin joformal, arsimimin e femrave analfabe, minoriteteve etj.
- Hartimin e planprogrameve lëndore për klasën e nëntë gjatë periudhës prill 2002 – gusht 2002 me ndihmën e grupeve të ekspertëve lëndorë (profesorë universitarë, ekspertë lëndorë dhe arsimtarë të lëndëve përkatëse);
- Miratimi i Planit dhe i Programit për klasën e 9 nga MASHT;
- U organizuan shumë debate dhe punëtori me ekspertë për mënyrën e përpilimit të planprogrameve, metodologjinë e re të mësimdhënies dhe të nxënies, standardet dhe vlerësimin, udhëzime didaktike, shfrytëzimin e burimeve mësimore etj;
- Janë organizuar seminare për të informuar ekspertët për zbatimin e planprogramit të klasës së nëntë në shtatë qendra rajonale (Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Prizren), ku janë përfshirë 1500 arsimtarë, këshilltarë arsimorë dhe zyrtarë të tjerë të arsimit.
- Është bërë përkthimi i planprogrameve për disa lëndë mësimore në gjuhët e minoriteteve (serbe, boshnjake dhe turke). Janë përgatitur planprogramet për klasën e nëntë edhe për pakicat që jetojnë në Kosovë.
- Sektori për zhvillimin e planprogrameve ka punuar në finalizimin e Kornizës së kurrikulit të Kosovës, (shtator – tetor 2002).
- Gjatë periudhës nëntor – dhjetor është punuar në strategjinë afatgjatë për zhvillimin e planprogrameve mësimore, në të cilën janë paraqitur fazat e zhvillimit të planprogrameve sipas niveleve dhe klasave.
- Në periudhën dhjetor 2002 - janar 2003 janë formuar grupet e ekspertëve për hartimin e planprogrameve lëndore për nivelet 1, 2, 3 (1 – 5; 6 – 9; 10 – 12/13) dhe planprogramet sipas klasave ( 1, 6, 10 ). Në tërë procesin për këtë vit vetëm për lëndët e përgjithshme janë përfshirë mbi 180 ekspertë lëndorë nga Kosova. Me grupet e ekspertëve nga Kosova po punojnë një grup i ekspertëve nga Sllovenia, ndërsa për gjuhën angleze, franceze dhe gjermane po punojnë edhe ekspertë ndërkombëtarë të angazhuar nga zyrat që i përfaqësojnë këto shtete në Kosovë.

- Edhe për zhvillimin e planprogrameve mësimore për grupe të tjera etnike në Kosovë janë formuar grupet e ekspertëve lëndorë nga gjuha amtare, historia, muzika dhe arti figurativ, por janë angazhuar edhe disa ekspertë nga këto minoritete për lëndët e tjera me ekspertët shqiptarë. Tash, për shkak se nuk ka gatishmëri nga një pjesë e pakicës serbe që të integrohet në këto rrjedha, ekipet e ekspertëve lëndorë me mësim në gjuhën serbe ende nuk janë kompletuar.
- Grupet e ekspertëve vendorë janë duke punuar në zhvillimin e planprogrameve lëndore. Mbahen debate dhe konsultime për këtë proces. Janë mbajtur edhe dy seminare me ekspertë lëndorë lidhur me zhvillimin e planprogrameve sipas standardeve bashkëkohore. Në mars 2003 do të mbahet seminari me temën: “Studimi i përvojave në zhvillimin e planprogrameve lëndore”.
- Gjatë muajit shkurt dhe mars 2003 janë nënshkruar kontratat edhe me ekspertë e tjerë ndërkombëtarë për zhvillimin e planprogrameve, të cilët do t’u ndihmojnë në aspektin profesional ekspertëve kosovarë.

#### **6.2.Njësia për Aftësimin e Punëtorëve Arsimor**

Është përgjegjëse për hartimin e planeve, rregulloreve dhe kriterëve për aftësimin e arsimtarëve pa shkëputje nga puna dhe të arsimtarëve me shkëputje nga puna; identifikimin e nevojave për aftësim të arsimtarëve; bashkrendim të punëve me agjencitë prirëse apo institucione trajnuese, me Njësinë e Planeve dhe Programeve dhe Njësinë e Standardeve dhe Verësimit, për zbatimin e strategjive dhe të metodologjive të ndryshme në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Njësia për Aftësimin e Punëtorëve Arsimor njëherësh është edhe udhëheqëse dhe bartëse e aktiviteteve të Këshillit për Shqyrtimin e Aftësimit të Mësimdhënësve në Kosovë (KSHAM).

Njësia për Trajnimin e Punëtorëve Arsimor, gjatë periudhës njëvjeçare mars 2002 – mars 2003, ka kryer një varg aktiviteteve të rëndësishme:

- Trajnimi i mësimdhënësve që janë pa shkëputje nga puna (in-service) dhe personelit administrativ pa shkëputje nga puna (in-service);
- Koordinimi i punës me ofruesit e programeve për trajnim dhe me donatorë;
- Trajnimi i stafit të Njesisë për trajnim të MASHT-it;
- Udhëheqja dhe përcjellja e punës së KSHAM-it;
- Përgatitja dhe trajnimi i mësimdhënësve gjatë studimeve (para shërbimit);
- Trajnimi i mësimdhënësve kryesisht u organizua gjatë pushimeve verore përmes “Institutit veror”. Kjo ishte një iniciativë e Projektit Kanadez për Aftësimin e Mësimdhënësve në Kosovë (KEDP);
- Gjatë muajt prill 2002 u hartua edhe plani strategjik, duke u bazuar në nevojat e mësimdhënësve për trajnime të ndryshme, dhe në bazë të prioriteteve të caktuara. Në këtë plan strategjik janë përfshirë të gjitha komunat e Kosovës. Planin strategjik është aprovuar nga të gjithë ofruesit e trajnimeve dhe janë përcaktuar edhe kriteret për aplikim të mësimdhënësve, shpërndarjes së seminareve sipas nevojave dhe prioriteteve në komuna, si dhe janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e ofruesve të trajnimeve;
- Përgatitjet teknike i bëri KEDP, duke botuar një doracak me listën e organizatave trajnuese, fushave trajnuese, orarin e trajnimeve, temat të cilat do të trajtoheshin gjatë seminareve, mënyra e aplikimit të mësimdhënësve dhe e administratorëve, si dhe kriteret për zgjedhje;

- Bartës të programeve ishin vetë organizatat trajnuese, ndërsa bashkërenditjen, kontrollimin dhe vlerësimin e punës u bëri Njësia për Trajnim në kuadër të MASHT-it dhe KEDP;
- Gjatë muajt maj 2002 kjo Njësi, në bashkëpunim me KEDP, organizoi takime rajonale të përbashkëta me Zyrtarët e Lartë Arsimorë (ZLA) dhe Zyrtarët Arsimorë (ZA), përgjegjës për komuna përkatëse, si dhe me Drejtorët Komunalë të Arsimit (DKA) me qëllim të paraqitjes së planit strategjik;
- Gjatë muajve qershor, korrik, gusht 2002 u organizua “Instituti veror”, në të cilin mbi 20 organizata ofruan trajnime për mësimdhënës dhe personel administrativ dhe në të cilin morën pjesë mbi 4500 mësimdhënës dhe rreth 500 punëtorë administrativë (drejtorë, zyrtarë arsimorë, drejtorë të drejtorive komunale, etj.). Në këtë projekt u përfshin edhe grupet etnike: boshnjakë, turq, romë e ashkali. Programet kanë qenë të ndryshme dhe në kohëzgjatje 1 – 9 ditë.
- Në këto seminare u paraqitën trajnerët vendës, të cilët ishin trajnuar deri në këtë kohë dhe të cilët, në cilësinë e moderatorëve, patën një paraqitje të mirë;
- Gjatë muajit shtator, Njësia për Trajnim dhe Grupi për hartimin e planprogrameve, organizuan seminarin njëditor me mësimdhënësit e klasëve të nënta (9) me ç`rast u prezantuan planprogramet mësimore për klasën 9;
- Mbledhja e informatave dhe përpunimi i tyre, pranimi i raporteve vlerësuese nga terreni, analiza e punës për “Institutin veror”, u vlerësuan mjaft të suksesshme.
- Duke pasur parasysh se tash kemi një numër mësimdhënësish, drejtorësh dhe zyrtarësh arsimorë, të cilët ishin përgatitur si trajnerë, u fokusua në një qasje të re, duke inicuar dhe motivuar organizimin e kurseve trajnuese me bazë në shkollë.
- Mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, të cilët kishin vijuar seminarët trajnuese gjatë verës, tani do të organizojnë takime të ndryshme brenda shkollës, në të cilat do të marrë pjesë i gjithë personeli arsimor dhe do të shkëmbehen përvoja të ndryshme.
- Në kuadër të Projektit për barazi gjinore, gjatë muajve shtator, tetor dhe nëntor, stafi i Shërbimit për Trajnim mbajti ligjërata me temën: ”Trajnimi i mësimdhënësve në Kosovë”.
- Në janar 2003 është themeluar rrjeti i trajnerëve vendorë. Me ndihmën e organizatave dhe të donatorëve të ndryshëm dhe, veçanërisht, të KEDP-së dhe ADRA – Danimarkë, është marrë nisma që të zhvillohet kapaciteti i trajnerëve vendorë.
- Gjatë shkurtit dhe marsit 2003 janë themeluar qendrat rajonale të trajnerëve vendorë dhe po mbahen seminare të ndryshme me qëllim të ngritjes së tyre profesionale në cilësinë e trajnerëve.
- Gjatë shkurtit dhe marsit 2003, janë organizuar seminare me mësimdhënësit mentorë, të cilët po përgatiten për të pranuar studentët e Fakultetit të Edukimit për të kryer praktikën profesionale. Këto trajnime po mbahen në katër qendrat ku Fakulteti i Edukimit ka degët e veta. Deri më tani janë mbajtur 4 seminare në secilën nga qendrat rajonale të Fakultetit të Edukimit dhe mësimdhënësit mentorë janë përgatitur mjaft mirë që t’i ndihmojnë studentët e këtij fakulteti që të përgatiten konform programeve të reja dhe metodave më bashkëkohore të mësimdhënies;
- Identifikimi i nevojave të mësimdhënësve për ngritje profesionale;

- Njësia për Trajnimin e Mësimdhënësve mban takime të rregullta mujore me të gjitha organizatat qeveritare dhe joqeveritare, ndërkombëtare dhe vendore;
- Përcaktimi i kriterëve rreth organizimit, zbatimit, aprovimit dhe vlerësimit të projekteve të ndryshme trajnuese, për zgjedhjen dhe aftësimin e trajnerëve vendorë, për aprovimin e programeve trajnuese të organizatave të ndryshme;
- Në shtator 2002, tre anëtarë të KSHAM-it u dërguan në një vizitë studimore 4 ditëshe në Slloveni ku u njohën me punën që bëhet atje rreth trajnimit të mësimdhënësve dhe zhvillimit të politikave e rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me trajnimet.
- Në tetor 2002 u organizua një vizitë studimore në Kanadë, ku morën pjesë anëtarë nga KSHAM-i. Kjo ishte vizitë e suksesshme, meqë Kanadaja ka një sistem të përparuar të arsimit dhe kosovarët përfituan shumë nga kjo vizitë.
- Në maj 2002 KSHAM-i miratoi Rregullorën mbi standardet e praktikës profesionale. Është një dokument që do të shfrytëzohet si mjet për të definuar cilësinë e mësimdhënies. Dokumenti përshkruan njohuritë, shkathtësitë dhe tiparët që kanë të bëjnë me kompetencat themelore të programeve përgatitore për mësimdhënësit fillestar, për mësimdhënësit të cilët janë duke ushtruar profesionin e mësimdhënies, por edhe për përsosjen profesionale të mësimdhënësve në përgjithësi;
- Në nëntor 2002, në KSHAM filloi hartimi i Projektregullores për aprovimin e programeve trajnuese për mësimdhënës pa shkëputje nga puna dhe personelin administrativ që u finalizua në shkurt 2003;
- Në shkurt 2003 KSHAM-i filloi punën në harimin e kodit etik për punëtorët arsimor, i cili, po ashtu, u finalizua në mars 2003;
- Në mars 2003 KSHAM-i filloi punën në hartimin e rregullores mbi sistemin e licencimit të mësimdhënësve dhe të personelit administrativ, rregullore kjo që është mjaft e rëndësishme dhe pritet të finalizohet në qershor të vitit 2003.

### 6.3. Njësia për Standarde dhe Vlerësim

Është përgjegjëse për zhvillimin e standardeve në planitprogramet mësimor dhe standardeve të arritshmërisë për nivelin 0, 1, 2 dhe 3 si dhe për zhvillimin e instrumenteve për matje dhe vlerësim në nivele të cekura më lartë; për hulumtime profesionale statistikore, për shpjegime shkencore të anëve të dobëta dhe të forta në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies si dhe në vetë sistemin e arsimit, me qëllim të ekzaminimit të gjendjes reale në në system.

Mbi bazën e kësaj, i jep rekomandime Ministrisë për hapat që duhen ndërmarrë për t'i evituar devijimet dhe pengesat e ndryshme në realizimin e objektivave të MASHT-it.

Njësia për Standarde dhe Vlerësim ka funksionuar si pjesë e projektit të FTP – International – Finlandë, i cili ka filluar më 1 korrik 2001, dhe gjatë vitit 2002/2003 ka arritur:

- Të aftësohet personeli, nëpërmjet një procesi trajnues nga ekspertë ndërkombëtarë dhe nëpërmjet aktiviteteve praktike, që personeli vendor ka ndërmarrë, për të vërë bazat e një strukture të qëndrueshme profesionale për standarde dhe vlerësimin në arsim;
- Të zhvillojë hulumtime për metoda të reja të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm;

- Të zhvillojë metoda të vlerësimit për qëllime të ndryshme;
- Të hartojë materiale për teknika të ndryshme për vlerësim;
- Të punojë për zhvillimin e instrumenteve përkatëse të matjes dhe të vlerësimit;
- Të shkruajë, të rishkrujë dhe rishqyrtojë kërkesat e Testit provë; formimin e formave ekuivalente të testit dhe administrimin e testit provë në terrin në mënyrë shkencore, duke përcaktuar kritere për numrin e nxënësve që duhet patjetër t'i përgjigjen një kërkesë të testit (prill 2002);
- Të përpunojë rezultatet e testit provë në mënyrë kompjuterike;
- Të formojë test kombëtar nëpërmjet rishqyrtimit të kërkesave të testit provë; formimin e formave ekuivalente të testit kombëtar;
- Të zhvillojë dhe të administrojë testin kombëtar në lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë turke dhe matematikë për nxënësit e klasës së katërt të shkollës fillore (tetor 2002);
- Të përpunojë të dhëna statistikore dhe njëkohësisht të analizojë rezultatet e testit kombëtar, si dhe të bëjë shpalljen interne të rezultateve të testit të parë kombëtar nëpër komuna dhe në MASHT, por jo edhe për publikun; mesatarja e arritshmërisë ishte 50 % (mars 2003);
- Të trajnojë arsimtarët në përdorimin e doracakut për arsimtarë - Metodën dhe Teknikat e vlerësimit (janar 2003).
- Të zhvillojë draftin e parë të standardeve për lëndët: Gjuhë shqipe, Gjuhë turke, Matematikë, Shkencat natyrore, për nivelin e parë ( 1 );
- Të organizojë seminare me Njësinë e Zhvillimit të Planprogrameve dhe të Aftësisë të Punëtorëve Arsimor, me arsimtarë dhe drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme për sistemin e ri të vlerësimit (24 qershor 2002);
- Të marrë pjesë në vizita studimore në Finlandë, ku u përvetësuan përvojat e çmuara të sistemit të vlerësimit (19 maj 2002) dhe në Shkup (shtator 2002);
- Të aftësohet për përpunime statistikore dhe programe kompjuterike që kanë të bëjnë me analiza të rezultateve (shkurt 2003);

#### 6.4. Njësia e Mjeteve Mësimore

Është përgjegjëse për përpilim të planit botues të teksteve shkollore, shpallje të konkursit, kontaktim dhe kontraktim të punëve me autorët dhe me shtëpitë botuese për botimin e teksteve dhe të mjeteve të tjera mësimore, mbikëqyrjen e cilësisë së botimit të teksteve dhe të mjeteve të tjera si dhe rekomandime për Këshillin e Planeve e Programeve dhe të Teksteve Shkollore.

Nga muaji mars 2002 deri në mars 2003:

- Është vlerësuar plani për botim të Librit Shkollor dhe është lejuar botimi i librave për klasët dhe lëndët përkatëse nga niveli parashkollorë deri në shkollat e mesme (Gjimnazi dhe Shkollat profesionale);
- Është shpallur konkurs për zhvillimin e teksteve shkollore për klasën e nëntë, në tetor 2002, dhe kanë arritur dorëshkrimet e para;
- Është lejuar edhe botimi i teksteve: Gjuha shqipe, Bazat e së drejtës, Informatika dhe Matematika për klasën e 9 orientuese. Gjatë kësaj periudhe është botuar edhe Matematika për klasën e 8 si dhe material pedagogjik për nxënës dhe arsimtarë;
- Është lejuar importimi i disa teksteve mësimore nga Turqia për nxënësit në Gjuhën turke. Më parë për këto tekste është bërë vlerësimi nga një komision profesional i formuar nga MASHT;

- Është lejuar dhe financuar importimi i teksteve nga Bosnja dhe Hercegovina për nxënësit dhe arsimtarët e minoritetit boshnjak. Komisioni i zgjedhur profesional ka bërë vlerësimin dhe së shpejti tekstet do të jenë në përdorim.

## **VII. 7. Sektori i Arsimit të Përgjithshëm**

Përfaqëson komponentën administrative të arsimit të niveleve të ndryshme të shkollimit (0, 1, 2 dhe 3), përveç arsimit profesional. Puna kryesore e këtij sektori është të udhëheqë të gjitha punët administrative, si: planifikim dhe përgatitje të propozim-rregulloreve për funksionimin e shkollave në përputhje me Ligjin e arsimit fillor dhe të mesëm, identifikim të nevojave, mbledhje të të dhënave për shkollat dhe propozim të masave të ndryshme për avansimin e arsimit të përgjithshëm. Sektori bashkëpunon me Zyrën ligjore, të Inspektorit, Sektorin e Koordinimit me Komunitet dhe me Njësinë e Informimit.

### **7.1. Njësia e Arsimit Parashkollor**

Është përgjegjëse për hartim të strategjive dhe të rregullativës së nevojshme për përfshirje dhe ngritje të numrit të fëmijëve në arsimin parashkollor; organizim të mbikëqyrjes profesionale dhe të kushteve fizike të mjedisit shkollor; ndihmë në organizim dhe funksionim të parashkollave dhe nxitje bashkëpunimi në arsimin parashkollor me komunitetin. Gjatë periudhës njëvjeçare të punës janë arritur këto rezultate:

- Përgatitja e rekomandimeve për strategjinë e zhvillimit në Arsimin e fëmijërisë së hershme (AFH) në Kosovë;
- Raporti i punës dhe analizë të përgjithshme krahasuese të gjendjes në arsimin parashkollor-parafillor 2000/01-2001/02;
- Plani vjetor i punës për vitin 2003;
- Përgatitja e projekteve: “Rregullimi dhe pajisja e ambientit të jashtëm të 35 institucioneve parashkollore (0.9 muaj – 6 vjet) në Kosovë”, “Rregullimi dhe pajisja e ambientit të jashtëm të 290 shkollave fillore që kanë paralele parafillore (5-6 vjeç) në Kosovë”, “Trajnimi i edukatoreve, të cilat në klasë kanë fëmijë me nevoja të veçanta”;
- Përpunimi i të dhënave statistikore për arsimin parashkollor - parafillor për vitin shkollor 2002/2003;
- Vendosja e kriterëve për qendrat me bazë në komunitet ;
- Rregullore mbi punën e Këshillit të Prindërve në institucione parashkollore;
- Plani strategjik pesëvjeçar për edukimin parashkollor - parafillor në Kosovë.
- Elemente të politikës arsimore për përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta në edukimin parashkollor;
- Koordinim të projekteve për AFH me UNICEF dhe OJQ-të tjera ;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me DKA dhe ZZHA;
- Rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor-parafillor;
- Pajisja më cilësore e institucioneve parashkollore e paraleleve parafillore me material didaktik ;
- Udhëzime administrative lidhur me organizimin e punës në institucione parashkollore e paralele parafillore.

### 7.2.Njësia e Arsimit Fillor

Është përgjegjëse për hartim të strategjive dhe të rregullativës së nevojshme për përfshirjen e të gjithë nxënësve në arsimin fillor; organizim të mbikëqyrjes profesionale dhe të kushteve fizike të mjedisit shkollor; të ndihmës në organizimin dhe funksionimin e shkollave fillore; të kujdesjes për përfshirjen adekuate të kuadrit në shkollë dhe të nxitjes së bashkpunimit të shkollës me komunitetin dhe këshillin e prindërve.

Duke qenë hallka më e rëndësishme e shkollimit të obligueshëm, kjo njësi gjatë vitit 2002/2003 ka bërë:

- Përgatitjen e listës së të gjitha shkollave fillore (amë) në tërë Kosovën dhe atë të numrit të nxënësve prej klasës I - VIII, si dhe listën e shkollave që janë pavarësuar dhe kanë ndryshuar emrat gjatë vitit 2001/02 në komunat e ndryshme;
- Përpunimin e të dhënave për numrin e nxënësve dhe personelit që punon në shkollat fillore;
- Korrigjimin e listave të mësimdhënësve në tërë Kosovën;
- Përgatitjen e programit të punës për njësinë;
- Përpilimin i projekt-propozimeve;
- Koordinimin e aktiviteteve me institucionet e tjera dhe OJQ-të e ndryshme;
- Punën rreth zgjerimit të rrjetit të shkollave mike (pilot) edhe në 35 shkolla të tjera dhe rritjen e efektshmërisë së programit, aty ku zbatohet;
- Përgatitjen e planit të punës për vitin 2003;
- Hartimin e një drafti për sigurinë e nxënësve në shkollat tona në bashkëpunim me të tjerët brenda MASHT-it;
- Shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të shtruara prej shkollave të ndryshme dhe DKA;
- Takime të ndryshme (me rëndësi për punën dhe ecjen përpara të proceseve);
- Raportimet për punën e bërë;
- Të gjitha këto aktivitete dhe të tjera kanë bërë që gjatë këtij viti Njësia të konsolidohet dhe të pasurohet me informata, të cilat kanë mundësur njohjen e drejtpërdrejtë të gjendjes në shkollat fillore; kjo ka ndihmuar që pastaj aty ku kanë qenë nevojat e ngutshme, të veprohet më shpejt;
- Në një numër të konsiderueshëm të shkollave janë formuar Këshillat e Prindërve – Arsimitarëve, të cilët kanë ndryshuar për të mbarë gjendjen në shkolla;
- Marrja e disa përgjegjësive prej MASHT-it nga disa agjenci udhëheqëse në Kosovë, të cilat kanë ndihmuar dhe ndihmojnë arsimin fillor në Kosovë.

### 7.3.Njësia e Arsimit të Mesëm të Ulët

Është përgjegjëse për hartim të strategjive dhe të rregullativës së nevojshme për përfshirjen e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë; organizim të provimeve pranuese së bashku me Njësinë e Vlerësimit; propozim të rrjetit të shkollave të mesme të larta; organizim të mbikëqyrjes profesionale dhe të kushteve fizike të mjedisit shkollor; ndihmës në organizimin dhe funksionimin e shkollave të mesme të larta; kujdesjes për përfshirjen adekuate të kuadrit në shkollë dhe nxitjes së bashkëpunimit të shkollës me komunitetin dhe këshillin e prindërve.

Kjo njësi gjatë periudhës njëvjeçare ka arritur:

- Të organizojë mësim plotësues në gjuhën amtare dhe në gjuhë e shtetit prej të cilit kthehen nxënësit nga diaspora;

- Të ndajë shkollat e mesme profesionale me numër të madh nxënësish;
- Të planifikojë lirimimin, meremetimin e konvikteve të shkollave të mesme të Kosovës;
- Të përpilojë planin operativ për integrimin e nxënësve të kthyer nga diaspora;
- Të propozojë dhe të ndihmojë në përgatitjen e Vendimit për ndërprerjen e provimeve me korrespondencë; Vendimit për lejimin e afatit të provimeve për vitin e parë (I) të Gjinnazit “Zenel Hajdini” në Gjiilan; Rregulloren me kalendarin e vitit shkollor 2002/2003; Udhëzimin Administrativ për sistemimin e nxënësve të kthyer nga diaspora; Udhëzimin Administrativ për kompensimin e orëve të humbura 1-15. 10. 2002; Udhëzimin Administrative për kompensimin e orëve të humbura për festën e 28 Nëntorit dhe festën e Bajramit; Udhëzimin Administrativ për mbajtjen e provimeve me korrespondencë (viti III dhe IV ); Udhëzimin Administrativ për avancimin e nxënësve të talentuar; Udhëzimin Administrativ për plotësimin e formularëve statistikorë për vitin shkollor '02- 03;
- Të përpunojë shënime statistikore për vitin shkollor 2002 / 2003;
- Të koordinojë punët për hartimin e planprogrameve në gjuhën turke;
- Të korrigjojë disa lëndë mësimore në gjimnaze dhe shkolla të mesme profesionale;
- Të përgatitë aspekte teknike dhe procedurale për 3 bursa në Itali dhe 1 në Kanada – mars-prill 2002;
- Të përgatitë për bursën e KBB-së (UWC) – prill - maj 2003;
- Të shqyrtojë dhe kryej, prej kërkesave me shkrim, 33 lëndë;
- Të bëjë nostrifikimin e 404 dëftësive – diplomave të marra në botën e jashtme,
- Të bëjë verifikimin për origjinalitetin e 120 diplomave;
- Të bëjë ekuivalencën e 13 diplomave të shkollave të mesme dhe të fakulteteve.

#### **7.4.Njësia e Arsimit Special**

Është përgjegjëse për planifikim dhe zbatim të procedurave administrative për organizim dhe funksionim të shkollave speciale, zbatim të metodologjive profesionale për identifikimin, ekzaminimin dhe sigurimin e kushteve për përfshirjen e të gjithë nxënësëve me nevoja të veçanta - arsimimin special. MASHT ka qasje të drejtpërdrejtë në arsimimin special sipas Ligjit të arsimit fillor dhe të mesëm.

Drejtohet nga një shef i njësisë, i cili është përgjegjës për bashkërendimin e të gjitha punëve në njësi dhe këshillon udhëheqësin e Sektorit për çështjet që kanë të bëjnë me punën e njësisë. Gjatë periudhës njëvjeçare njësia ka punuar në tri drejtime:

- Zhvillimi i sistemit të arsimit gjithëpërfshirës;
- Themelimin e sistemit të shërbimeve kadrovike, që të mbështetet zhvillimi profesional nëpërmjet trajnimit të mësimdhënësve parashërbimit dhe pa shkëputje nga puna drejt arsimit gjithëpërfshirës;
- Përmirësimin e ndërtimit të kapaciteteve arsimore në AGJ (Inkluzionin)

#### *Zhvillimi i sistemit të arsimit gjithëpërfshirës*

- Në mars 2002 MASHT / Shërbimi i Arsimit Special ka krijuar strategjinë e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e obliguar arsimor;

- Janë nxjerrë udhëzime nga Shërbimi i arsimit special për hapjen e 33 klasëve të reja speciale në shkollat e rregullta;
- Në prill 2003 është formuar Grupi Këshillues Shëndetësor, nga 5 anëtarë në çdo rajon, i cili ka bërë klasifikimin e fëmijëve sipas llojit të dëmtimit;
- Janë hartuar kritere për themelimin e klasave speciale;
- Në maj 2002 është ndarë buxheti për mallra dhe shërbime dhe buxheti kapital për secilën komunë ku është hapur klasa speciale;
- Pesë qendra rajonale të themeluara nga FDSEK-u bëjnë trajnime dhe seminare të DSHEGJ;
- FSDEK-u (Përkrahja Finlandeze në Zhvillimin e Arsimit në Kosovë) ka trajnuar personelin e shkollave në klasat e bashkëngjitura / KB.

#### *Ndërtimi i kapaciteteve*

##### *arsimore në arsimin gjithëpërfshirës*

- Janë organizuar trajnime për arsimin gjithëpërfshirës për mësuesit;
- Janë trajnuar 135 mësues të 25 shkollave pilot (shk. të rregullta - nga 5 shkolla për çdo qendër rajonale);
- Janë trajnuar 140 drejtorë dhe 39 mësues të rinj për arsimin special dhe pranuan certifikatat e aftësisë në qershor 2002. Trajnimi u organizua edhe në zonat serbe sipas DSHEGJ C për 150 mësues minoritarë nga 10 shkolla pilotë;
- Programi i trajnimit rajonal është zhvilluar sipas informatave kthyesë dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- Vlerësimi i trajnimit DSHEGJ C është shkruar si rast për studimin e përvojës së grupit të anëtarëve të FSDEK-ut;
- Shkolla “Elena Gjika” dhe “Thimi Mitko” kanë vazhduar zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe, në këtë kontekst, kanë arritur sukses;
- Është bërë vetëdijësimi i opinionit përmes seminareve, trajnimeve, vizitave dhe artikujve të publikuar në media të ndryshme, radio dhe televizione lokale dhe qendrore;
- Njësia e Arsimit Special ka punuar me autoritetet arsimore nëpër komuna për të kuptuar rëndësinë e klasave të bashkëngjitura dhe çështjet e tjera të arsimit gjithëpërfshirës;
- Është vlerësuar se është ngritur vetëdija dhe përkushtimi për t’i ndihmuar kategorisë së fëmijëve të ngritur;
- Është organizuar seminar me rreth 500 punëtorë të arsimit për arsimin gjithëpërfshirës (22 - 29 nëntor 2002);
- Njësia ka pasur bashkëpunim dhe konsultime me rreth 40 OJQ dhe nivele të tjera të arsimit.

#### ***Shkurtesat***

FSDEK .....Përkrahja Finlandeze për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë  
 KB .....Klasat e Bashkëngjitura  
 AGJ .....Arsimi Gjithëpërfshirës  
 MASHT.....Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë  
 ZHP.....Zhvillimi Profesional  
 NAS .....Njësia e Arsimit Special  
 ENV.....Edukimi për Nevoja të Veçanta  
 DSHEGJ.....Drejt një Shkolle Efektive për të Gjithë  
 DSHEGJ B....DSHEGJ- Trajnim për Komunitetin Shqiptar  
 DSHEGJ C....DSHEGJ- Trajnim për Serbët dhe Komunitetet Minoritare

### **7.5.Njësia e Arsimit Privat**

Është përgjegjëse për planifikim dhe zbatim të procedurave administrative në organizimin dhe funksionimin e arsimit privat, hartimin e planit veprues të njësisë, propozim të dokumenteve të nevojshme për licensimin e arsimit privat në përputhje me kriteret e caktuara më parë. Mbatjen e regjistrimit dhe kontrollimin e punës në shkollat private. Gjatë periudhës njëvjeçare njësia ka arritur:

- Të hartojë Planin Strategjik pesëvjeçar për shkolla private;
- Të hartojë planin dyvjeçar të aktivitetit të njësisë;
- Të konsultojë kriteret e vendeve të ndryshme të botës për IAP;
- Të përgatitë kriteret për Udhëzimin Administrativ për Licencimin e IAP-it në nivel parauniversitar;
- Të identifikojë institucionet private, të cilat veprojnë aktualisht të palicensuara për të gjitha nivelet e shkollimit, të cilat nga MASHT konsiderohen si ilegale dhe të paligjshme;
- T'u ofrojë ndihmën profesionale themeluesve dhe përfaqësuesve të IAP-it;
- Të informojë të interesuarit për hapjen e IAP-it përmes mjeteve të informimit;
- Të pranojë kërkesa për licencimin e IAP-it të nivelit fillor, të mesëm dhe të lartë;
- Të marrë pjesë për aftësim profesional në Romë - tetor 2002;
- Të hartojë raporte, informacione dhe shkresa të ndryshme të rëndësishme për njësinë.

### **VII. 8. Sektori i Arsimit Profesional**

Përfaqëson komponentën administrative dhe profesionale të arsimit të mesëm të lartë apo nivelit 3. Puna kryesore e sektorit është të udhëheqë të gjitha punët administrative, si: planifikim dhe përgatitje të propozimrregullore për funksionimin e shkollave profesionale në përputhje me Ligjin e arsimit të mesëm, identifikim e nevojave, mbledhjen e të dhënave për shkollat dhe propozim e masave të ndryshme për avansimin e arsimit profesional.

Kontaktin, në përputhje me kërkesat, me institucionet qeveritare dhe joqeveritare, për të hulumtuar nevojat e ekonomisë së tregut në mënyrë që të bëjë lidhjen e arsimit profesional me nevojat e ekonomisë së Kosovës.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Sektorin për Zhvillimin e Planprogrameve, zhvillon planprogramet mësimore në përputhje me rrjetin e profileve të ndryshme të arsimit profesional. Bashkëpunon edhe me Zyrën Ligjore, të Inspektorit, Sektorin e Koordinimit me Komunitet dhe me Njësinë e Informimit. Sektori ka ndërmarrë hapa konkret për arritjen e objektivave dhe të detyrave të planifikuara për mars 2002/2003, si:

- Zhvillimi i planprogrameve për klasën 9 – pjesa e lëndëve profesionale (qershor - shtator 2002);
- Reformimi i mësimdhënies / Trajnimi i një numri të mësimdhënësve të shkollave pilot të GTZ dhe Swiss Contact-it - pranverë/vjeshtë 2002 (ky proces është në vazhdim);
- Analizë e gjendjes në shkollat profesionale / përmes pyetësorit të përgatitur nga Sektori i Arsimit Profesional (prill 2002);
- Përpilimi i “Statutit të shkollave profesionale pilot” (pranverë 2002). Në këtë punë është involvuar MASHT (Sektori i Arsimit Profesional, Zyra Ligjore, shkollat profesionale), GTZ, Swiss Contact. Dokumenti është përgatitur në

tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Dokumenti i është dorëzuar Sekretarit të Përhershëm për nënshkrim, para se të hyjë në fuqi;

- Zhvillimi i planprogrameve për këto profesione: automekanik, ujësjelles, instalimet elektrike, rrobaqepësi, kompjuteristik, mekanik i makinave, ngjyrosja e veturave, riparues i pajisjeve shtëpiake, teknologjia e nxehtë dhe e ftohtë, murator, zdrukhtar, biznes-kompjuter-anglisht, berber (gjatë 2002). Këto kurrikule janë në formë moduli, të përshtatura për trajnim të të rriturve; duhet të përshtaten për nxënësit e niveleve të ndryshme shkollore;
- Certifikimi dhe standardizimi profesional, projekt i filluar në vitin 2002 dhe vazhdon edhe këtë vit. Projekt i përbashkët mes MASHT dhe MPMS, i ndihmuar nga Agjencioni Evropian, GTZ, Swiss Contact lidhur me vendosjen e kriterëve të përbashkëta për certifikimin në shkollat profesionale dhe qendrat trajnuese për të rriturit. Projekti parasheh krijimin e një mekanizmi të përkohshëm me qëllim të sigurimit të standardeve dhe të cilësisë së kërkuar, duke involvuar konkurrencën e tregut të gjerë;
- Memorandumi i mirëkuptimit, i nënshkruar mes MASHT, MPMS dhe Agjencionit Evropian (2002) për “Zhvillimin e arsimit dhe trajnimit profesional” në drejtime të zgjedhura (elektronikë, administratë biznesi dhe teknologji informative). Projekti ka filluar në nëntor të vitit 2002 dhe do të zgjasë 18 muaj;
- Zhvillimi i arsimit profesional në Kosovë - dokument strategjik i zhvilluar nga Sektori i Arsimit Profesional (nëntor 2002 - mars 2003). Dokumenti është duke u përkthyer në disa gjuhë (pritet të jetë në gjuhën shqipe, gjermane, serbe, turke dhe angleze) dhe pastaj të dalë në diskutim publik. Është planifikuar një konferencë me të interesuar të ndryshëm për arsim profesional në pranverë 2003, ku do të merren informatat kthyesë për këtë dokument. Dokumenti përmban pasqyrën se si do të duken shkollat profesionale në të ardhmen në Kosovë;
- Vizitë e Grupit të partneritetit (shtator-2002) lidhur me punësimin në Kosovë. Ky projekt është pjesë e programit të stabilitetit.
- Inicimi i analizës së tregut të punës; vizitë e ekspertit gjerman dr. Dostal lidhur me këtë çështje (tetor 2002) - raporti dhe propozimi për Kosovë (shkurt 2003);
- Vizitë e Grupit të partneritetit “Peer group“ (shtator 2002) lidhur me punësimin në Kosovë. Ky projekt është pjesë e programit të Paktit Stabilitetit, i cili synon përmirësimin e situatës në aspektin e punësimit në Kosovë; i njëjti grup përgatit raportin dhe propozimet (mars 2003) për përmirësim të situatës;
- Identifikimi i profesioneve prioritare / seminar i mbajtur me ekspertë vendorë në lëmenj të ndryshëm, me qëllim të identifikimit të nevojave urgjente në tregun kosovar të punës;
- Zhvillimi i stafit për arsim profesional / vizita studimore në Gjermani dhe Austri, të organizuara nga GTZ, Ministria e Arsimit në Vienë, ETF, Pakti i Stabilitetit për trajnimin permanent të stafit në lëminë e arsimit profesional;
- Vizita e Ministrisë së Arsimit të Austrisë në Kosovë / tema: arsimi profesional në shkollat speciale, arsimimi në burg dhe arsimimi në spitale;
- Vizita e „Viena Education Board“, zbatimi i arsimit profesional: “Klasat model për ekologjifemë, kopshtari dhe floristikë, teknikat e nxemjes dhe të elektroteknikës”.

*Përmirësimi i mjedisit  
të punës në shkolla*

- Pajisja e punëtorive në shkollat profesionale pilot: Prishtinë “Shtjefën Gjeçovi”, Pejë “Shaban Spahija”, Prizren “Gani Çavdërbasha”, Kaçanik “Voskopoja”, Gjakovë “Nexhmedin Nixha” etj., ka mundësuar kryerjen e praktikës profesionale, e cila deri me tani është arritur të realizohet;
- Trajnimi i mësimitdhënësve në shkollat pilot në metodologjinë e re të mësimitdhënies, ka përmirësuar cilësinë e mësimit;
- Renovimi i një numri të shkollave profesionale ka përmirësuar kushtet e punës;

## **VII. 9. Sektori i Arsimit të Lartë**

Përfaqëson komponentën administrative dhe profesionale të arsimit të lartë. Puna kryesore e tij është që të udhëheqë të gjitha punët administrative, si: planifikimi, strategjia e zhvillimit dhe përgatitja e propozimrregulloreve dhe udhëzimeve administrative për funksionimin e arsimit të lartë në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë; identifikimi i nevojave; mbledhja e të dhënave për arsimin e lartë dhe propozimi i masave të ndryshme për avansimin e arsimit të lartë.

Krijon kontakte të nevojshme me institucionet qeveritare dhe joqeveritare për të hulumtuar nevojat e ekonomisë së tregut në mënyrë që të ndihmojë institucionet e arsimit të lartë dhe institutet shkencore për të pasur qasje më të lehtë në zbatimin e programeve dhe të projekteve të tyre në ekonominë e Kosovës dhe jashtë saj. Ndhmon në planifikimin e buxhetit për Universitetin dhe institutet shkencore; ndihmon në procedurat financiare; përgatitë dokumentacionet e nevojshme për kontrollimin e arritjes së cilësisë nëpërmjet vlerësimit të jashtëm (AAK).

### **9.1.Njësia e Universitetit**

Gjatë periudhës njëvjeçare të punës së njësisë janë arritur rezultate modeste, si:

- Hartimi i ligjit mbi arsimin e lartë, i miratuar nga Parlamenti i Kosovës në shtator dhe nëntor 2002, porse i panëshkruar nga PSSP i KB-ës, (mosmiratimi i këtij ligji është bërë pengesë e madhe në zhvillimin e aktiveteve të planifikuara në universitet).
- Identifikimi se Universiteti i Prishtinës punon me një Statut me fuqi ekzekutive të përkohshme;
- Hartimi i planit strategjik për zhvillimin e arsimit të lartë 2003 – 2007;
- Hartimi i planit të veprimit për vitin akademik 2002/2003;
- Përgatitja e kritereve dhe propozimeve për nxjerrjen e udhëzimeve administrative për participimin e studentëve në shkollim;
- Krijimi i një ambienti të sigurt për të gjithë studentët dhe personelin akademik e administrativ në zhvillimin e shkathtësive dhe të aftësive të tyre për ngritje të cilësisë së mësimitdhënies, mësimitdhënies dhe të cilësisë në punën kërkimore, shkencore etj.;
- Ngritja e një sistemi për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë – themelimi i Agjencisë së Akreditimit
- Ndërkombëtarizimi i IAL-it përmes bashkëpunimit me IAL në rajon, Evropë e më gjerë, sikurse janë seminarët e organizuara nga UNESCO/CEPES - tetor 2002 në Kluzhna Opaka, Rumuni, për udhëheqjen e financimit në AL - nëntor 2002 në Budapest; Sigurimi i cilësisë në procesin e mësimitdhënies dhe

të mësimnxënies në AL - dhjetor 2002 në Bon – Gjermani, shkurt 2003 në Londër, seminare të cilat do të vazhdojnë në vitin 2003;

- Participimi i studentëve nëpërmjet sistemit publik financiar me destinim për univerzitetin për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies (duke iu mundësuar shtesë në pagë mësimdhënësve dhe bursa për studentët e dalluar), për t'u ndihmuar kategorive të studentëve, të cilët janë invalidë të luftës, invalidë fizikë shëndetësorë dhe atyre që janë në asistencë sociale, si dhe për aktivitete të studentëve dhe pajisje me mjete mësimore;
- Zhvillimi i mëtutjeshëm i reformave në Universitetin e Prishtinës sipas standardeve evropiane. Në Universitetin e Prishtinës janë duke u zhvilluar aktivitete për 5 projekte të financuara nga Programi TEMPUS në shumë prej **881, 795 Euro** në këto lëmi: Administrimi i biznesit, Lidhshmëritë e Universitetit me industrinë, Trajnimi i mësimdhënësve, Sigurimi i cilësisë në arsim, si dhe Administrata qendrore e informimit;
- Në vitin 2002/2003 finalizohen në të gjitha Fakultetet planprogramet e reja sipas Deklaratës së Bolonjës (3+2+3 apo 4+1+3 vite). (Përveç Fakultetit të Mjekësisë, të gjitha Fakultet e tjera janë duke punuar sipas Deklaratës së Bolonjës dhe të gjitha provimet do të vlerësohen në bazë të ECTS në vitin akademik 2002 / 2003);
- Hartimi i projekteve të ndryshme, si dhe aplikimi në programe si p.sh. TEMPUS, CEPUS, po ashtu edhe pjesëmarrja në aktivitete të organizuara nga UNESCO – CEPES;
- Është siguruar mbështetja e themelimit të Universitetit Amerikan në Prishtinë;
- Hartimi i strategjisë për përparimin e punës kërkimore dhe teknologjisë, po ashtu dhe ndërtimi i kapaciteteve në Akademi dhe në Institute në kuadër të aktiviteteve të Akademisë dhe UP. Është përkrahur seminari i gjuhës shqipe, i organizuar në gusht 2002;
- Strategjia e mirëfilltë e bashkëpunimit të institucioneve për punë kërkimore me industrinë në mënyrë që përfitim të jetë i dyanshëm;
- Hapja e Laboratorit qendror të financuar nga qeveria gjermane, i cili do të shërbejë për punë praktike të studentëve dhe po ashtu edhe për shërbime profitabile, që të dëshmojë lidhshmërinë e Universitetit me industrinë dhe ekonominë. Aktivitetet e zhvilluara në këtë Laborator do të jenë shembull edhe për IAL të tjera, të cilat do të ngrisin vetëdijen në Universitet për rolin e industrisë dhe të ekonomisë në financimin e IAL, po ashtu edhe ngritje të cilësisë së punës në ndërmarrjet e ndryshme përmes shërbimeve të kryera nga ekspertët e Universitetit.
- Instalimi i programit kompjuterik në të gjitha fakultetet për mbledhjen e të dhënave për personelin mësimor dhe administrativ dhe përpunimin e tyre;
- Bashkëpunimi me organizatat qeveritare dhe Joqeveritare në ngritjen e fondeve për realizimin e aktiviteteve të ndryshme të sektori të arsimit të lartë p.sh. bashkëpunimi me Qendrën e Arsimit të Kosovës, Këshillin Britanik, Zyrën Amerikane, UNDP etj., p.sh. për organizimin e Konferencës për themelimin e Agjencisë së Akreditimit, që do të mbahet më 9 dhe 10 maj 2003, po ashtu edhe për hartimin e testit të standardizuar psikometrik për pranimin e studentëve në disa degë të UP-ës.
- Me kërkesën e MASHT-it, Njësia e Revizionit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është duke e bërë një revizion financiar në Universitetin e Mitrovicës.

- Është përpiluar një raport detaj për punën e Universitetit të Mitrovicës dhe për listën e punëtorëve të Universitetit, ku dyshohet për manipulime.

### **9.2. Akademia dhe institutet**

Puna njëvjeçare e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës ka qenë e përqendruar në:

#### *Veprimtari botuese*

- Janë botuar 9 tituj të ri nga fusha të ndryshme të shkencës dhe të arteve ( I. Ajeti, "Vepra 5", S .Riza ,,"Vepra 3", M.Dushi "Trepça-Sistemi integral tekniko-teknologjik", R. Dhomi "Arie nga opera dhe këngë solo", H.Gashi, "Kosova, Strategjia dhe zhvillimi", Sh.Braho "Pedologjia",
- Artistët kosovarë, Revista, Studime 8-9 dhe Revista "Kërkime 10

#### *Projekte shkencore*

Janë plane afatgjata të Akademisë. Projekti më i madh është **Enciklopedia shqiptare**, projekt i përbashkët i Akademisë sonë dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

- Është finalizuar puna edhe në projektin tjetër të përbashkët të dy Akademive tona "**Fjalori i emrave të bimëve**". Fjalori pritet të dal nga shtypi së shpejti. Në realizim e sipër janë edhe projektet: "**Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë**", pastaj "**Fjalori i termave të informatikës**","**Fjalori i termave të muzikës**" etj.
- Tubimet shkencore dhe aktivitetet artistike të ASHAK-së:
- Është mbajtur konferenca shkencore e përbashkët e dy Akademive tona me temën: "**Shqipja standarde**" me pjesëmarrjen e katër akademikëve tanë (I. Ajeti, B. Bokshi, R. Ismaili dhe R. Qosja);
- Është shënuar 100-vjetori i vdekjes së Jeronim De Radës, në Prishtinë dhe në Tiranë;
- Është organizuar Ekspozita e përbashkët e anëtarëve të ASHAK (I. Kodra, M. Mulliqi, A. Çavdarbasha, Gj. Gjokaj, R. Ferri dhe T. Emra);
- Ekspozita retrospektive e Tahir Emrës ( mars 2003);
- Janë organizuar ligjërata nga anëtarët e jashtëm të ASHAK-së etj.

#### *Bashkëpunimi ndërkombëtar i ASHAK*

Bashkëpunimi ndërakademik ndërkombëtar ka qenë preokupim tjetër i ASHAK. Përveç vazhdimit të bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, ka pasur kontakte dhe bashkëpunim konkret edhe me Akademinë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve, me Akademinë Mbretërore Belge, Flamane të Shkencave dhe Arteve dhe me Akademi të tjera, me të cilat pritet së shpejti nënshkrimi i Marrëveshjeve përkatëse bashkëpunimi.

#### *Instituti i historisë*

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë gjatë kësaj periudhe kohore rëndësi të veçantë u ka kushtuar institucioneve shkencore, duke stimuluar dhe përkrahur konkretisht në realizimin e projekteve të shumëta shkencore-kërkimore dhe artikstike. Gjatë kësaj periudhe, Instituti i Historisë ka realizuar planprogramin e paraparë të veprimtarisë së tij në këto fusha:

#### *Veprimtaria Shkencore*

- Është hartuar projekti shkencor “ **HISTORIA E KOSOVËS**”;
- Gjatë këtij viti Instituti ka bashkëpunuar me Institutin e Historisë në Tiranë në realizimin e projektit “**HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR**”;
- Instituti dhe punonjësit e tij kanë realizuar një numër të caktuar zërash për “**FJALORIN ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR**”;
- Punonjësit e Institutit janë angazhuar në grupin e ekspertëve për hartimin e planprogrameve të historisë për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- Gjithashtu punonjësit e Institutit kanë realizuar edhe projekte të veçanta shkencore.

#### *Tubime Shkencore*

- Është mbajtur Akademi përkujtimore me rastin e 100 – vjetorit të vrasjes së patriotit Haxhi Zeka;
- Më 14 maj 2002 është organizuar shënimi i 35-vjetorit të Institutit të Historisë;
- Më 27. 6. 2002 është mbajtur sesioni shkencor kushtuar 55-vjetorit të KNDSH-së;
- Më 22 nëntor 2002 në Prishtinë është mbajtur sesioni shkencor kushtuar 90-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë;
- Më 26 nëntor 2002 është organizue Konferenca Shkencore në Tiranë kushtuar 90-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë;
- Është ngritur Këshilli Organizues për konferencën shkencore me rastin e 125-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

#### *Veprimtaria botuese*

- Instituti ka përgatitur për shtyp revistën shkencor “**Kosova**” nr. 22-23;
- Revistën historiko-politike “**Kosova**” nr. 9 në gjuhën angleze dhe shqipe;
- Studimin “**Dokumente historike për kryengritjet e mëdha antiosmane 1910-1912**”.

#### *Instituti Albanologjik*

Gjatë vitit 2002 – 2003, punëtorët shkencorë të Institutit Albanologjik në Prishtinë janë angazhuar në realizimin e 36 projekteve të tyre kërkimore-shkencore. Gjatë kësaj periudhe punëtorët shkencorë të Institutit kanë botuar një numër të madh punimesh në revistat shkencore në vend dhe jashtë. Kanë marrë pjesë në tubime shkencore të organizuara nga institucionet shkencore në Kosovë, Shqipëri dhe në botën e jashtme. Tre nga punonjësit shkencorë të Degës së Folklorit kanë qëndruar për studime shkencore në institucionet e jashtme, në SHBA, në Finlandë dhe në Austri.

Instituti Albanologjik në bashkëpunim me institucionet e Shqipërisë ka organizuar tri ekspozita shkencore në terren me ç’rast janë vjelë materiale të rëndësishme nga folklori, etnologjia, dhe gjuhësia (dialektologjia leksikografia dhe onomastika). Ekspeditat janë realizuar në Has të Shqipërisë, në rrethinat e Kaçanikut dhe në Ferizaj. Gjatë kësaj periudhe janë botuar revistat “Gjurmime Albanologjike”, nr. 28-29, të tri serive dhe nr. 30, Folklor dhe etnologji, si dhe dy numra të revistës “Gjuha Shqipe”, 2002.

Instituti albanologjik nuk u nënshtrohet rregullave të MASHT lidhur me organet drejtuese të Institutit.

***Biblioteka Kombëtare  
dhe Universitare e Kosovës***

MASHT-i gjatë kësaj periudhe kohore rëndësi të veçantë i ka kushtuar funksionimit dhe udhëheqjes së BKUK, sepse, siç dihet, ajo përballlet me probleme të trashëguara të një udhëheqje shumë të dobët, e cila e kishte dërguar BKUK në buzë të bllokimit të plotë të punës së saj. MASHT, më 30 gusht 2002, emëroi Bordin ekzekutiv të BKUK, i cili mori të gjitha përgjegjësitë e udhëheqjes së BKUK.

Bordi miratoi një propozim të ofruar nga Zyra e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë për të sjellë këtu një ekspert të SHBA-ve, me shpenzime të kësaj zyreje, si Drejtor i përkohshëm në BKUK. Roli i tij ishte që të përfaqësonte Bordin Ekzekutiv në administrimin e punëve ditore të bibliotekës dhe të mbikëqyrte dhe të ndihmonte organizimin e brendshëm të Bibliotekës dhe ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar bibliotekar.

Dr. Kenneth Oberembt mori përgjegjësinë si drejtor i përkohshëm më 14-tetor 2002 dhe e përfundoi më 11 mars 2003. Më pas vazhdoi punën si Këshilltar i lartë i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për zhvillimin e Bibliotekës, duke e ndihmuar Drejtorin kosovar të Bibliotekës dhe duke u angazhuar në planin afatgjatë strategjik të zhvillimit të BKUK-së.

Gjatë kësaj kohe u hartua plani për organizimin e **Javës së Bibliotekës së Kosovës** (e cila korrespondon me Javën e Bibliotekës Kombëtare të SHBA-ve) duke besuar se kjo do jetë një formë e mire stimulimi dhe bashkëpunimi, për të ndihmuar në të gjitha aspektet BKUK-në, që do të krijojë lidhje të fuqishme mes publikut të gjerë dhe misionit të bibliotekës dhe se do të ofrojë mundësi të mirë për të kërkuar donatorë dhe për të ndihmuar në zhvillimin e mëtejshëm të BKUK-ës.

Bordi Ekzekutiv kërkoi nga MASHT të bëjë revizionin e mjeteve materiale për shkak të keqpërdorimeve të mjeteve buxhetore. Revizioni i MASHT-it e filloi punën më 24 tetor 2002, që të bëjë hetimet e nevojshme të mostransparencës në transaksionet financiare dhe të parregullësive në pagat e personelit të BKUK-ës. Një revizion tjetër është duke u bërë edhe nga Njësia e Revizionit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Bordi i rekomandoi Ministrinë të Arsimit ngritjen e një ndërtese në kompleksin e Universitetit të Prishtinës si seli e ardhshme e Bibliotekës së re Qendrore të Universitetit të Prishtinës, kur BKUK të themelohet Bibliotekë Kombëtare e Kosovës, sipas Ligjit për Bibliotekat.

Bordi në pajtim me procedurat e MASHT-it propozoi dr. Sali Bashotën për emërim Drejtor i Bibliotekës, në janar të vitit 2003. Miratoi edhe një varg masash që kanë të bëjnë me parimin e riorganizimit të BKUK-së.

Qysh tash efektet e para pozitive janë dukur në funksionimin e brendshëm dhe të jashtëm, renovimin e hapësirave të brendshme, krijimin e fondeve të librave të tjetërsuara në rrugë të ndryshme, rregullimin e mjedisit të jashtëm etj.

***Qendra e Studentëve***

Qendra e Studentëve në korrik të vitit 2002 ishte në gjendje shumë të rëndë, si në aspektin e organizimit dhe të funksionimit të shërbimeve, po ashtu edhe në pikëpamje financiare. Qendra kishte pësuar rënie të madhe financiare, kurse 240 punëtorëve të saj nuk u paguheshin të ardhurat, edhe ashtu të vogla (mesatarja e së cilës ishte 100 euro) me muaj të tërë. Shërbimet, si ai i strehimit, i ushqimit, i mirëmbajtjes teknike e i kontabilitetit, ishin tërësisht të rrënuara. Qendra e studentëve e UP vitin 2002, sa i përket strehimit dhe ushqimit të studentëve, e kishte mbyllur me humbje prej 300.000 euro, të cilat ishin borxhe ndaj furnizuesve dhe humbje ose avullim i mjeteve në

sektorin e strehimit (fjetjes). Ndërsa, sipas raportit të revizionit financiar të ish AQF-ës, në kohën kur administratori ndërkombëtar Paull Mullhollm udhëheqte Qendrën e Studentëve, nuk kishte mbulesë për 138.000 Euro.

Në vitin e kaluar në konviktet e studentëve ka mbretëruar gjendje shumë e rëndë. Papastërtia ishte e madhe. Nuk ka pasur ngrohje në konvikte me vite të tëra, ndërsa për ujë të ngrohtë për pastrim as që mund të mendohej. Për shkak të mungesës së ngrohjes qendrore, studentët kanë përdorur kaloriferë me rrymë dhe si pasojë ka pasur djegie të mëdha të instalimit të rrymës në të gjitha konviktet si dhe lëndime të shumëta të studentëve, e posaçërisht në konviktet e vajzave. Dhomat e studentëve nuk ishin të gëlqerosura që 15 vjet; shtretërt ishin klasik dhe të mbuluar me dyshekë të cilësisë së dobët (të ndihmave); ushqimi i studentëve ishte tejet i varfër dhe mungonte pastërtia themelore në restaurant e në mensë; stabilimentet dhe inventari ishin shumë të dëmtuara.

Për ilustrim po theksojmë se personeli i Qendrës së Studentëve ishte mbi 90% i pakualifikuar, pa asfarë trajnimesh dhe në tërë kompleksin nuk kishte njeri që dinte ta përdorte kompjuterin (për habi në qendër nuk kishte asnjë kompjuter, punohej me makina të shkrimit në gjithë sektorët e Qendrës së Studentëve).

Për shkak të udhëheqjes së dobët në Qendër, MASHT më 15 korrik 2002 emëroi drejtor të ri të Qendrës së Studentëve z. Nazmi Halimi.

#### *Rezultatet e punës*

- Është siguruar pastrimi i rregullt i të gjitha konvikteve, si nyje sanitare, dhoma etj. Është renovuar stacioni i vjetër i ngrohjes lokale dhe i furnizimit me ujë të ngrohtë për pastrim, i cili me forca vetanake është riparuar dhe shkëputur nga Termokosi. Prandaj, Qendra e Studentëve në sezonin dimëror ka arritur t'i furnizojë të gjitha konviktet me ngrohje dhe ujë të ngrohtë për pastrim.
- Agjencioni Evropian i Rindërtimit ka ndihmuar që të ndërtohet Stacioni i ri i ngrohjes.
- Është sanuar gjendja tepër e rëndë financiare dhe vetëm gjatë muajëve tetor-dhjetor 2002 janë mbuluar shpenzimet dhe janë likuiduar të gjitha borxhet. Pagesa mujore për fjetje dhe ushqim për një student është 70 euro.
- Qendra e studentëve financohet nga dy burime financiare: nga pagesa e studentëve dhe nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.
- Qendra është shfrytëzues i vogël i mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, pasi që në shkallë vjetore nuk shfrytëzon më shumë se 700.000 euro, ndërkaq 70% të mjeteve i siguron nga mjetet vetanake.
- Që nga shkurti i këtij viti, me propozim (dhe rekomandim) të MASHT-it, Drejtorja e Qendrës ka marrë vendim që studentëve t'u japë edhe racionin e ushqimit të mëngjesit, ku për herë të parë prej se ekziston kjo Qendër, studentët kosovarë kanë tri racione të ushqimit në ditë, pa e ndryshuar çmimin e pagesesë - 70 euro për një student.
- Janë marrë masa efikase edhe në sektorin e ushqimit, ku janë aftësuar të gjitha pajisjet e kuzhinës, pastërtia është shumë më e mirë, është korrigjuar mënyja e ushqimit, tani është më e pasur për çdo racion dhe shërbimi është tejet profesional.
- Që nga tetori i vitit të kaluar nuk ka pasur asnjë ankesë nga studentët qoftë për ngrohje, ushqim apo ndonjë problem tjetër.

- Aktualisht në Qendrën e Studentëve është duke u zbatuar projekti i pajisjes me orendi i të gjitha konvikteve i financuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

## **VII. 10. Sektori i Arsimit të Komuniteteve dhe Gjinisë**

Është përgjegjës për zbatimin e politikës së MASHT në raport me arsimin e komuniteteve pakicë, planifikimin e masave, organizimin dhe zbatimin e projekteve konkrete për përfshirjen e komuniteteve dhe të gjinisë në rrjedhat e arsimit të rregullt me të drejta të barabarta për arsimim. Në këtë drejtim janë shënuar rezultate të konsideruara me përjashtim të komunitetit serb, i cili ende heziton në integrimin e sistemit të arsimit kosovar edhe pse janë marrë masa administrative, por, për shkak se kjo çështje konsiderohet e drejt e rezervuar, kemi ende vështirësi.

Si rezultat i punës njëvjeçare të këtij sektori, janë arritur këto rezultate:

- Sigurimi i arsimimit cilësor në të gjitha nivelet, duke përfshirë këtu edhe edukimin e lartë, në gjuhët amtare për komunitetet, të cilat jetojnë në Kosovë (serbët, boshnjakët, turqit, kroatët, romët, hashkalitë dhe egjiptasit);
- Integrimin e të gjitha komuniteteve, që respektojnë dallimet etnike dhe krijimi i një shoqërie shumë etnike nëpërmjet të arsimit;
- Ofrimi i mundësive të barabarta për shkollim si për djemtë ashtu edhe për vajzat, si dhe mbrojtja e të drejtave femërore në të gjitha sferat e jetës shoqërore, kulturore dhe politike;
- Hapja e Fakultetit të Biznesit në Pejë, ku studiojnë 40 studentë boshnjakë. Ky është institucioni i parë i lartë arsimor për boshnjakët dhe paraqet një moment shumë të rëndësishëm në shkollimin e lartë të boshnjakëve;
- Realizimi i projektit për botimin e “POCETNICE “- s, tekstit të parë shkollor në gjuhën boshnjake për nxënësit e klasës së parë të shkollës fillore. Teksti (tirazhi 1000 copë) është financuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe është shpërndarë falas të gjithë nxënësve të klasës së parë të shkollës fillore në gjuhën boshnjake. Kjo është një ndihmesë dhe përkrahje e madhe për të gjithë nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit boshnjakë në Kosovë;
- Zhvillimi (krijimi) i planprogrameve për klasën e IX në gjuhën serbe, boshnjake dhe turke. Me këtë, për herë të parë komunitetet janë kyçur në krijimin e planprogrameve mësimore, me çfarë ata marrin pjesë në reformat dhe mund të ruajnë identitetin e tyre gjuhësor, kulturor dhe fetar. Secili komunitet ka nevojat dhe specifikat e veta, të cilat e përbëjnë llojllojshmërinë e një shoqërie dhe të cilat kontribuojnë në mbajtjen dhe zhvillimin e pasurisë kulturore dhe traditave;
- Për herë të parë është hapur konkursi për hartimin e teksteve mësimore në gjuhën boshnjake dhe atë turke për klasën e IX. Konkursi është hapur për këto lëndë: Gjuhë amtare dhe letërsi, Histori, Kulturë muzikore, Art figurativ;
- Përkrahja e projektit dhjetë ditor për trajnimin e mësimdhënësve në gjuhën Turke, lidhur me aplikimin e metodologjisë bashkëkohore në shkencat natyrore. Projekti është realizuar në bashkëpunim me Zyrën Turke në Prishtinë;
- Është përgatitur dhe gjendet në shtyp planprogrami për klasën e IX në gjuhën turke dhe atë boshnjake. Ai do t'i ndihmojë mësimdhënësve gjatë punës së tyre me nxënësit, lidhur me planprogramet dhe literaturën;
- Është aprovuar dhe gjendet në fazën e zbatimit projekti për sigurimin e teksteve për shkollat fillore në gjuhën boshnjake. Pasi që nxënësit nuk kanë

- tekste, Ministria e ka pranuar buxhetin prej 120, 000 Euro për këtë projekt. Nxënësit do të përodrin këto tekste deri në krijimin e planprogramit të përbashkët mësimor dhe hartimit të teksteve në bazë të këtij planprogrami;
- Me gjithë përpjekjet e institucioneve Kosovare dhe bashkësisë ndërkombëtare, serbët ende nuk janë të inkuadruar në sistemin e arsimit të Kosovës.
- Ministria rregullisht shpall konkurse për pranimin e drejtorëve dhe zyrtarëve të Ministrisë në gazetat ditore në gjuhën serbe, në mjediset serbe. Një numër i vogël lajmërohet. Kështu p.sh. për drejtorë shkollash kanë konkuruar vetëm 17 kandidatë, për dhjetë vende të hapura;
  - Është organizuar transporti nga shkolla deri në shtëpi dhe anasjelltas. Për këto nevoja janë siguruar 20 autobusë , nga ana e UNDP-së, në 13 komuna. Deri në fund të vitit 2002. këta autobusë kanë qenë nën përcjellje të KFOR-it. Tani transporti bëhet pa përcjellje;
  - Sektori është i kyçur në procesin e ngeciatave për eliminimin e strukturave paralele, dhe në atë drejtim bisedat vazhdojnë;
  - Sektori mban kontakte me shkolla të ndryshme. Interesohet për nevojat dhe problemet e tyre, në mënyrë që t'i ndihmoj ata. Në atë drejtim Ministria ka ndërmarrë hapa pozitiv;
- Kujdes i veçantë i kushtohet ngritjes së standardave arsimore të komuniteteve rome, hashkali dhe egjiptias, të cilët ballafaqohen me nivel posaçërisht të ulët arsimor dhe përfshirje jo të plotë të popullatës në shkollim. Për këtë janë ndërmarrë hapat në vazhdim:
- Janë formuar klasat e mësimit intensiv (catch-up class) në komunën e Pejës, të Gjakovës dhe të Shtimjes, në bashkëpunim me OJQ në Save The Children. Këtu përfshihen fëmijët e moshës 9-17-vjeçare, të cilët për ndonjë shkak s'kanë pasur mundësi të vazhdojnë shkollimin. Janë përfshirë 275 fëmijë. Qëllimi është që fëmijët më vonë të inkuadrohen në shkolla të rregullta.
  - Shkolla verore në Vushtrri dhe Leposaviq, 2 dhe 6 muaj, gjithsej ka përfshirë 65 nxënës. Tani të gjithë nxënësit janë të inkuadruar në shkolla të rregullta.
  - Në Prizren dhe Ferizaj një projekt me kohëzgjatje 6 mujore është financuar nga ana e IRC-së, dhe është mbikëqyrur nga Ministria. Janë përfshirë 382 nxënës të cilët kanë përfunduar kurset dhe projekti pritet të vazhdojë edhe 6 muaj. Të lartpërmendurit do të marrin certifikata për kurset e përfunduara me sukses.
  - Ndarja e certifikatave nga ana e MASHT-it për 113 nxënës u bë në komunë të Gjakovës dhe të Vushtrrisë.
  - Sektori punon në zbatimin e projekteve për barazi gjinore. Në Vushtrri është përfunduar projekti “Barazia gjinore, të drejtat e njeriut dhe demokracia në arsim”. 38 pjesëmarrëse kanë marrë diplomat. Qëllimi është sigurimi i arsimit për të gjithë dhe përkrahja e femrave për të vazhduar shkollimin. Kjo do të ndihmoj në pjesëmarrjen e tyre në ndërtimin e shoqërisë civile.
  - Zbatimi i projektit përfaqësimi i çështjes gjinore në planprogramet e reja të Kosovës.

## **VII. 11. Sektori i Koordinimit me Komunitet**

Është pika kryesore për kordinim dhe komunikim institucional me komunitet dhe me komunitetin e prindërve. Është përgjegjëse për planifikim, organizim, kordinim dhe zbatim të politikës së MASHT në raport me komunitet, Këshillat e prindërve, duke patur kujdes në shmangien e dyfishimit të kompetencave ndërmjet të dy institucioneve me rëndësi për mbarëvajtjen e procesit arsimor; edhe pse sektori më i

ri në MASHT është ballafaquar me veprimtari të ndieshme dhe ka treguar rezultate mjaft të mira në:

- Organizimin me sukses të intervistave për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave të mesme dhe fillore;
- Zgjedhjen e drejtorëve, të cilit aktivitet së pari i parapriu shpallja publike e konkursit mbi bazën e Ligjit të Arsimit Fillor dhe të Mesëm dhe Udhëzimit administrativ më 16.11. 2002;
- Për pozitën e drejtorit në 75 shkolla të mesme, pa shkollat serbe, kanë aplikuar 255 kandidatë. Pas përpilimit të listës së ngushtë, janë intervistuar 140 kandidatë dhe janë zgjedhur 44 drejtorë të shkollave të mesme, 17 prej të cilëve janë zgjedhur të rinj dhe 27 drejtorë janë rizgjedhur. 5 drejtorë të shkollave të mesme janë zgjedhur femra. Promovimi i drejtorëve të shkollave të mesme dhe nënshkrimi i kontratave është bërë më 30 janar 2003;
- Për pozitën e drejtorit në 494 shkolla fillore, (pa shkollat serbe) kanë aplikuar 1008 kandidatë. Janë zgjedhur 92 drejtorë të rinj dhe janë rizgjedhur 146 drejtorë;
- E tërë procedura për zgjedhjen dhe emërimin e drejtorëve të shkollave fillore, të mesme dhe shkollave speciale, është mbështetur në Ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm dhe Udhëzimin Administrativ MASHT [I] 19/2002, datë 12 nëntor 2002. Fillimisht është hartuar strategjia e veprimit, duke përfshirë edhe përcaktimin e orarit dhe formimin e komisioneve. Për secilën komunë, komisionet për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave kanë pasur nga tre anëtarë (Drejtori komunal i arsimit, Zyrtari i lartë i arsimit dhe një përfaqësues i MASHT-it, i cili ka qenë në cilësinë e kryetarit të komisionit) që janë mbështetur edhe nga 2 anëtarë konsultativë (një prind nga Këshilli i prindërve të shkollës dhe një mësimitdhënës, përfaqësues i shkollës);
- Në 6 shkollat speciale në Kosovë, për pozitën e drejtorit kanë aplikuar 7 kandidatë. Me këtë rast janë zgjedhur drejtorët e 2 shkollave speciale, njëri prej të cilëve është femër;
- Për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të kandidatëve të paraqitur në konkurs dhe me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga ligjet, gjithnjë duke synuar procedurën e rregullt, komisionet e përbërë nga 1 përfaqësues i MASHT-it, Zyrtari i lartë i arsimit për shkollën e komunës përkatëse dhe 1 përfaqësues i Shërbimit të arsimit special, kanë vendosur që për 4 shkollat e tjera të arsimit special konkursi të përsëritet;
- Arsye kryesore për përsëritjen e konkursit në shumë shkolla është mungesa e kundërkandidatëve. Kudo që në konkurs është paraqitur vetëm 1 kandidat, MASHT-i ka vendosur që konkursi të përsëritet. Me këtë synohet respektimi dhe jetësimi i ligjeve dhe konkurrenca me më shumë kandidatë;
- Nganjëherë, edhe përkundër numrit të mjaftueshëm të kandidatëve që kanë aplikuar për drejtorë të ndonjë shkolle, për shkak të parregullësive të ndryshme MASHT ka vendosur ta rishpallë konkursin;
- Ka raste ku për shkak të pakënaqësisë me përgjigjet në pyetjet profesionale, Komisioni me vendim unanim kërkon rishpalljen e konkursit për drejtor të ndonjë shkolle të caktuar;
- Konkursi është përsëritur edhe në rastet kur ka pasur konflikt interesash;

- Kriter bazë me rastin e përpilimit të listës së ngushtë të kandidatëve që kanë konkurruar për drejtor, për secilën shkollë veç e veç, kanë qenë pikët e fituara nga kualifikimet profesionale të kandidatëve, si: përvoja në mësimdhënie dhe përvoja administrative/udhëheqëse;
- Rezultatet e intervistës, duke u përqendruar në aftësitë administrative/menaxheriale, njohuritë pedagogjike, aftësitë udhëheqëse dhe komunikative, kanë qenë kriteret themelore për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave filllore dhe të mesme të Kosovës.

## VII. 12. Sektori i Infrastrukturës

MASHT disponon me një pasuri të madhe të objekteve dhe të infrastrukturës shkollore. Sektori i infrastrukturës është përgjegjës për vlerësimin e nevojave të hapësirës shkollore, planifikimin dhe koordinimin e projekteve për përmirësimin e hapësirës shkollore dhe të infrastrukturës së objekteve shkollore, udhëheqjen dhe inspektimin e realizimit të projekteve të infrastrukturës në pajtim me standardet e ndërtimit, financimit dhe të prokurimit. Nxjerr dispozita për mënyrën e mirëmbajtjes së objekteve dhe infrastrukturës tjetër shkollore.

Gjatë vitit 2002 Sektori i infrastrukturës ka udhëhequr këto programe:

- Shkollat në ndërtim nga donatorët;
- Programin e mirëmbajtjes;
- Projektet nga buxheti kapital të shpërndara në regjione;
- Projektin e transportit shkollor;
- Përpilimin e listës për shkollat prioritare.

Numri i shkollave, të cilat janë në ndërtim nga donatorët është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme. Gjatë vitit 2002 donatorë kryesor ishin USAID dhe IDB.

Numri i shkollave të cilat ishin në ndërtim gjatë vitit 2002 është rreth 60. Gjatë kësaj kohe MASHT ka formuar listën e këtyre shkollave nga e cila shihet qartazi se çfarë lloji i punës është bërë. Me këtë nënkuptohet ndërtimi, renovimi, zgjerimi, uji dhe kanalizimi etj.

*Tabela e organizatave të cilat janë marrë me ndërtim gjatë viti 2002*

Organizata	Nr. i shkollave	Ndërtim i ri	Riparim	Aneks
USAID	19	1	17	1
IDB	16	16		
ADRA	6	6		
SDC	3	3		
Save The Child.	3	3		
DRC	1	1		
GTZ	7		7	
SCA	1	1		
PU	1	1		
CDF	3	3		
Gjithsej	60	35	24	1

*Vërejtje:* Ekziston mundësia e përjashtimit të ndonjë organizate për mungesë të të dhënave

Është e nevojshme të theksohet edhe programi i UNICEF-it, i cili gjatë këtij viti ishte përqendruar në rregullimin e ujit dhe të kanalizimit në disa shkolla e sidomos në shkollat ku janë të përfshira pakicat.

*Tabela e shkollave të cilat kanë marrë pëlqimin nga MASHT për intervenim në sistemin e ujësjellësit dhe të kanalizimit.*

Nr.	Komuna	Fshati/Qyteti	Emri i shkollës	Nr.i nxënësve	Etniteti
1	Lipjan	Gadime	Zenel Hajdini	1182	shqiptar & ashkali
2	Lipjan	Dobrotin	Knez Lazar	100	Serb
3	Kamenica	Kamenica	Desanka Maksimovic	250	Serb
4	Kamenica	Ropotov	Trajko Peric	188	Serb
5	Lipjan	Gornja Gusterica	Knez Lazar	50	Serb
6	Lipjan	Livadje	Knez Lazar	43	Serb

### ***Shkolla në Likovc***

Për ndërtimin e kësaj shkolle mjetet janë siguruar nga Brunei Darussalam dhe Mercy USA para viti 2002 por nuk kanë qenë të mjaftueshme, prandaj ka participuar edhe MASHT. Gjatë vitit 2002, kur edhe përfunduan punët në këtë shkollë, MASHT-ndau mjete edhe për pajisjet, inventarin e kësaj shkolle në mënyrë që objekti të hyjë në përdorim.

### ***Mirëmbajtja***

Ky program është disajnuar nga Sektori i Infrastrukturës me ndihmën e SDC – organizatë qeveritare zvicerane. Fjala është për mirëmbajtjen e të gjitha godinave shkollore në Kosovë. SDC dhe Sektori i infrastrukturës kanë zhvilluar këtë program për mirëmbajtjen e shkollave në Kosovë. MASHT-i dhe SDC duhet të vazhdojnë ende punën në realizimin e këtij programi.

### ***Projektet nga buxheti kapital***

Është e qartë se donatorët nuk mund të marrin barrën kryesore të ndërtimeve dhe riparimeve të mëtutjeshme, për këtë arsye MASHT ka marrë iniciativ për shfrytëzimin e buxhetit të Kosovës për riparime të shkollave. Këto mjete nga ky buxhet janë shpërndarë nëpër komuna në bazë të përparësive. Numri i objekteve që është intervenuar nga ky buxhet është 67.

- Gjatë vitit 2002 janë shpërndarë mjete edhe për disa programe speciale të komunave. Këtu përfshihen rajoni i Prishtinës me 8 objekte shkollore, rajoni i Prizrenit me 2 objekte shkollore dhe rajoni i Mitrovicës me 4 objekte shkollore.
- MASHT, në bashkpunim me drejtoritë komunale të arsimit, çdo vit përpilon listën e shkollave me përparësi, të cilat kanë nevojë për ndërtim apo renovim. Me anë të kësaj liste caktohen prioritet në të cilat pastaj shikohen mundësitë për intervenimet e nevojshme.
- Është ky një fond që mund të shfrytëzohet për mirëmbajtje të shkollave. Gjatë vitit 2002 mjetet nga fondi **Trust Fund** iu kanë ndarë komunës së Shtërpcës për shkollën e mesme serbe, pas djegies që ka pësuar.
- MASHT, më 6 mars 2003, i propozoi KK të Prishtinës planin detaj urbanistik për ndërtimin e objektit të ASHA të Kosovës, objektit të MASHT-it dhe objektit të Fakultetit të Edukimit. Pas bisedave me të gjitha strukturat lidhur me hapësirën për vendosjen e këtyre tri godinave, është mendim i përgjithshëm se lokacioni i propozuar nuk është në kundërshtim me parimet kryesore urbane dhe se destinimi i kësaj sipërfaqeje ka qenë dhe është i dedikuar për institucione arsimore e shkencore; ASHA e Kosovës parashihet

të ketë një sipërfaqe rreth 2.500 metra katrorë, MASHT të ketë një sipërfaqe 4 mijë metra katrorë dhe FE të ketë sipërfaqe rreth 2.500 metra katrorë. Lartësia e tri godinave propozohet të jetë  $BD+PR=3K$ .

### **VII. 13. Sektori i Mbështetjes Teknike**

Është përgjegjës për planifikim, organizim, kordinim dhe zbatim të planit të mbështetjes teknike, sigurim të rrjetit kompjuterik, internetit, rrjetit telefonik, sigurimit të shërbimit të logjistikës dhe furnizimit të brendshëm të MASHT-it. Në këtë sektor janë arritur rezultate të kënaqshme sipas njësive punuese:

#### *Njësia e Teknologjisë Informative*

- Ka bërë vendosjen e të gjitha pajisjeve të teknologjisë informative që është blerë dhe shpërndarë për punëtorët e MASHT-it;
- Është kujdesur për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative të MASHT-it.

#### *Njësia e Furnizimit*

- Gjatë kësaj periudhe, ka bërë të gjitha përgatitjet për krijimin e kushteve për punë për punëtorët e punësuar në MASHT;
- Shërbimi ka bërë furnizimin e MASHT –it me material shpenzues dhe inventar;
- Shërbimi, në bashkëpunim me shërbimet e tjera të këtij sektori, ka bërë inventarizimin e tërë inventarit të MASHT-it;
- Ka ndihmuar Sektorin e Prokurimit për realizimin e blerjeve sipas kërkesave që janë bërë nga udhëheqësit e departamenteve dhe sektorëve;
- Ka krijuar bazën e të dhënave, në të cilin mbahen të gjitha të dhënat lidhur me shpërndarjen e materialit shpenzues si dhe të materialit tjetër.

#### *Njësia e Transportit*

- Ka përgatitur formularin në bazë të të cilit janë bërë kërkesat për shfrytëzimin e veturave të MASHT-it;
- Ka siguruar transportin e arsimtarëve të minoriteteve me rastin e mbajtjes së disa seminareve;
- Ka nxjerrë udhëzime administrative për të përcaktuar politikat dhe procedurat e MASHT-it lidhur me mënyrën e përdorimit të automjeteve në administratën e MASHT-it;
- Ka bërë transportimin e punëtorëve të MASHT-it sipas kërkesave ditore;
- Ka lidhur kontrata për servisimin, riparimin e veturave si dhe kontrata për mbushjen e tyre me karburante;
- Ka siguruar transportin për minoritetet në relacionin shkollë – shtëpi, të cilin e financojnë UNOPS dhe është i mbështetur edhe nga MASHT.

#### *Shërbimi i Logjistikës*

- Ka bërë përcjelljen dhe inspektimin e të gjitha zyrave të MASHT-it, me qëllim të evitimit të problemeve të ashensorit, ngrohjes, klimatizimit dhe detektorëve, kundër pierjes së duhanit;
- Ka bërë kontrollimin e të gjitha pajisjeve kundër zjarrit, sistemin dhe shenjat. Kjo përfshin plotësimin e standardeve të sigurisë së MASHT-it, me qëllim që të gjitha pajisjet kundër zjarrit të jenë funksionale dhe të mirëmbajtura;

- Ka përcjellë dhe mbikëqyrur të gjitha punimet që janë bërë në objektin e MASHT-it;
- Ka mbështetur aktivitete dhe seminare të ndryshme të organizuara nga MASHT ose për MASHT.

## **IX. PENGESAT**

Gjatë punës njëvjeçare, MASHT është ballafaquar me pengesa të natyrave të ndryshme, të cilat e kanë vështirësuar realizimin e synimeve të planifikuara për këtë periudhë. Pengesat kryesore me të cilat MASHT u ballafaqua gjatë kësaj periudhe, mund të përmbliken në:

### *Mungesa e infrastrukturës së nevojshme ligjore*

Mosnënshkrimi i Ligjit për Arsimin e Lartë ka shkaktuar pasoja të paparashikueshme për zhvillimin e AL në Kosovë, me ç'rast punën e Arsimit të Lartë e ka përfshirë një gjendje me prirje të sjelljes jashtinstitucionale, jashtligjore dhe jashtsistimore. Si pasojë e kësaj është vështirësuar komunikimi dhe marrja e masave për përmirësimin e gjendjes.

Mungesa e rregulloreve dhe e udhëzimeve administrative të mjaftueshme për rregullimin e aktiviteteve të nevojshme në fushën e arsimit si pasojë e dinamikës së shpejt të zhvillimeve në arsim dhe ekspertëve të pamjaftueshëm ligjor në MASHT.

### *Buxheti i pamjaftueshëm*

Buxheti i vogël ka lejuar një pagë simbolike të punëtorëve ekzistues të arsimit dhe për pasojë është shkaktuar një erosion i personelit të kualifikuar në sistem dhe janë shkaktuar vështirësi të konsiderueshme në identifikimin dhe pranimin në punë të punëtorëve të kualifikuar, me përvojë dhe të aftë për përballimin e punëve profesionale në administratën qendrore dhe në tërë sistemin e arsimit. Si pasojë e kësaj u organizuan greva të punëtorëve të arsimit në tetor të vitit 2002 dhe po paralajmërohen greva të reja, ngase gjendja e rëndë materiale ka demotivuar për punë të suksesshme dhe ka vështirësuar zbatimin e reformave që po i synojmë si shoqëri. Gjithashtu, si pasojë e mungesës së mjeteve, shumë projekte vitale për zbatimin e reformave të filluara në arsim janë duke pritur donacione ndërkombëtare, që do të thotë se po e vështirëson realizimin me kohë të objektivave të MASHT-it.

Kjo e ka vështirësuar punën edhe më shumë kur dihet se shumë donatorë ndërkombëtarë tanimë e kanë reduktuar ose e kanë ndërprerë aktivitetin e tyre në tërësi, ndërsa shumë projekte kanë qenë të planifikuara që të realizohen nëpërmjet donatorëve përkatës.

Donatorë të shumtë kanë bërë punë të konsiderueshme, por jo edhe të mjaftueshme për funksionimin e plotë të institucioneve të arsimit kur dihet se shumë godina shkollore kanë nevojë për riparim, rindërtim, mirëmbajtje, por edhe ndërtimi i objekteve të reja shkollore. Pa ndihmën e donatorëve, vështirë do të arrihen këto objektiva.

### *Lëvizja e popullatës dhe aftësimi i punëtorëve arsimor*

Pas luftës u shkaktua një dyndje e madhe e popullatës nga fshati në qytet me çka u vështirësua puna e shkollave në qytet për shkak të mungesës së hapësirës, ndërsa në anën tjetër financohej në ndërtimin e shkollave në fshat, të rrënuara nga lufta, kurse vështirësitë e mbajtjes së procesit mësimor në qytet nuk evitoheshin dhe për pasojë është ulur shkalla e arritshmërisë së nxënësve në qendrat e mëdha urbane, si në

Prishtinë (rezultati i Testit kombëtar - shkalla e arritshmërisë është 55%, ose vend i 7 në nivel të Kosovës ).

Aftësimi i arsimtarëve dhe i personelit tjetër të shkollës u vështirësua nga lëvizjet e shpeshta dhe mungesa e planit strategjik të veprimit nga ana e agjencioneve të cilat merreshin me aftësimin e arsimtarëve, ngase vërehej një përfshirje sporadike e arsimtarëve në trajnime, të cilët në shumicën e rasteve ishin joefektiv në shkollat prej nga vinin. Gjithashtu, zbatimi i metodologjive të reja të mësimdhënies vështirësohet në mungesë të pajisjeve të nevojshme të shkollave me mjete mësimore dhe teknologji të informimit.

### *Informimi*

Në Kosovë aktualisht nuk ka informim objektiv dhe profesional të opinionit publik për punën e institucioneve arsimore. Sistemi i informimit është në proces të formimit profesional dhe nën presionin e ngjarjeve senzacionale të ditës, pa i vlerësuar efektet negative në krijimin e psikologjisë dhe të vetëdijes në opinion në raport me sjelljen e tij si rob i informatës së ditës dhe humbjen e vlerave të komunikimit të mirëfilltë të vlerave ndërmjet institucioneve shtetërore dhe publikut. Mjetet e informimit masiv vështirë të përcaktohen në informimin e publikut për ndonjë punë me vlerë në institucionet e arsimit etj., kurse vështirë është të punosh nga gazetarët e shumtë prej kërkesave të tyre për rastet ekcesive, pastaj shtrëmbrimi i tyre, varësisht nga simpatia dhe preferenca politike e ndonjë mediumi informative në raport me MASHT.

### **IX. Vazhdimësia**

MASHT, në kohën e themelimit të saj, më 4 mars 2002, e pranoi marrjen e përgjegjësisë nga DASH, strukturë e përbashkët e udhëheqjes së sistemit të arsimit nga ndërkombëtarët (UNMIK) dhe nga vendorët, me qasje parimore për vazhdimin e të gjitha programeve dhe projekteve të filluara nga DASH. Në përputhje me këtë, MASHT udhëhoqi politikë shumë parimore në vazhdimin e të gjitha programeve dhe projekteve për thellim të zbatimit të reformave të nisura në sistemin e arsimit. Si rezultat i kësaj, shumë programe dhe projekte janë përfunduar brenda vitit të kaluar, disa prej tyre janë në vazhdim e sipër dhe do të mbështeten nga MASHT deri në përfundimin e tyre me sukses dhe në anën tjetër shumë projekte presin të fillojnë në vitin 2003 me qëllim të vazhimit të ecjes drejt arritjes së objektivave të planifikuara nga MASHT.

Kjo është një qasje profesionale dhe pragmatike e MASHT për realizimin e vizionit të saj “Promovimi dhe zbatimi i idesë për një arsimim më të mirë për të gjithë në Kosovë, i bazuar në nevojat individuale dhe të shoqërisë kosovare”.

Puna e MASHT-it po vijon me një ritëm shumë të shpejtë drejt të ardhmes...

Prishtinë,  
10 prill 2003